



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



RAPORT I KRYETARIT TË KOMUNËS
PËR PUNËN E ORGANEVE TË KOMUNËS

JANAR – QERSHOR 2008

Gusht 2008, Prishtinë

Përmbajtja

1.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
2.	AKTIVITETET E KABINETIT TË KRYETARIT TË KOMUNËS	4
3.	ZYRAT	6
3.1.	Zyra ligjore	6
3.2.	Zyra për integritet evropian	6
3.3.	Zyra për auditim të brendshëm	7
3.4.	Zyra për marrëdhënie me publikun	8
3.5.	Zyra pritëse	8
3.6.	Zyra për ankesa	9
3.7.	Zyra e avokaturës publike	9
3.8.	Zyra për çështje gjinore dhe mundësi të barabarta	10
3.9.	Zyra për teknologji informative	10
3.10.	Zyra për kthim	11
3.11.	Zyra për komunitete	12
3.12.	Departamenti i prokurimit	13
4.	DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT	14
4.1.	Spektori i punëve të përgjithshme dhe juridike	14
4.2.	Spektori i shërbimeve të Kuvendit	14
4.3.	Spektori i bashkësive lokale	15
4.4.	Spektori teknik	15
4.5.	Spektori i gjendjes civile	15
5.	DREJTORIA E FINANCAVE, EKONOMISË DHE ZHVILLIMIT	16
5.1.	Të hyrat vetanake për periudhën janar-qershor 2008	16
5.2.	Realizimi i buxhetit për periudhën janar-qershor 2008	17
5.3.	Spektori i zhvillimit	18
5.4.	Spektori i bujqësisë	18
5.5.	Inspekcioni i tregut dhe i bujqësisë	18
6.	DREJTORIA E SHËRBIMET PUBLIKE DHE EMERGJENCËS CIVILE	19
6.1.	Spektori i shërbimeve publike	19
6.2.	Shërbimi elektro-energjetik	19
6.3.	Shërbimi i transportit	20
6.4.	Sinjalizimi horizontal dhe vertikal	20
6.5.	Shërbimi i mbrojtjes së ambientit	20
6.6.	Spektori i emergjencës civile	21
6.7.	Spektori i Inspektionit Komunal dhe Komunikacionit	22
7.	DREJTORIA E URBANIZMIT, KADASTRËS DHE MBROJTJES SË MJEDISIT	22
7.1.	Spektori i urbanizmit	22
7.2.	Spektori i gjeodezisë dhe kadastrit	24
7.3.	Spektori i inspektionit të ndërtimit	24
7.4.	Spektori i mbrojtjes së mjedisit	24
7.5.	Çështje tjera	24
8.	DREJTORIA E ARSIMIT, KULTURËS DHE SPORTIT	25
8.1.	Ngritja e infrastrukturës shkollore, kulture-sportive dhe furnizimet	25
8.2.	Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor	26
8.3.	Spektori i Kulturës	26
8.4.	Spektori i Sportit dhe Rinisë	27
8.5.	Shërbimi i punëve të përgjithshme administrative	27
8.6.	Aktivitetet e tjera	27
9.	DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS LOKALE	28
10.	DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE	30
11.	DREJTORIA E PRONËS	31
	SHTOJCË ME TË DHËNA	32
	Shtojca I: Të dhënat për aktivitetet e Kryetarit të Komunës për periudhën janar-qershor 2008	32
	Shtojca II: Të dhëna nga Drejtoria e Urbanizmit, Katastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit	33

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport i Kryetarit të Komunës paraqet aktivitetet e organeve komunale për periudhën janar-qershor 2008. Raporti është përgatitur për Kuvendin Komunal në përputhje me Statutin e Komunës së Prishtinës. Raporti fillimisht përshkruan aktivitetet kryesore të Kabinetit të Kryetarit të Komunës (Pjesa 2 e raportit) dhe pastaj aktivitetet e të gjitha zyrave (Pjesa 3) dhe drejtorive komunale (Pjesët 4-11) gjatë kësaj periudhe raportuese. Në shtojcë të këtij raporti janë paraqitur të dhënat që mbështesin këtë raport të renditura sipas radhës që paraqiten në raport.

Gjatë kësaj periudhe, janë kryer aktivitete në përputhje me objektivat programore të qeverisë komunale. Objektivi kryesor ka qenë rritja e efikasitetit të punës të të gjitha organeve komunale dhe implementimi i shumë projekteve kapitale. **Kuvendi Komunal** ka mbajtur 6 mbledhje të rregullta dhe 1 të jashtëzakonshme, ka miratuar statutin e Komunës së Prishtinës, 2 rregullore dhe 61 vendime të ndryshme. Gjithashtu janë mbajtur mbledhje të të gjitha komiteteve të Kuvendit.

Në **Drejtorinë e Administratës dhe Personelit** është rritur dukshëm efikasiteti i shërbimeve ndaj qytetarëve përmes orarit të zgjatur të shërbyesve civil në komunë dhe riorganizimit të shërbimeve. Janë marrë masa në rastet e paraqitjeve të jo efikasitetit në punë, siç është rasti tek shërbimi i inspektionit. Përshkrimi detal i aktiviteteve të kësaj drejtorie dhe i drejtorive dhe zyrave mund të gjendet në pjesët përkatëse të raportit.

Në **Drejtorinë e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit** është raportuar se gjatë periudhës janar-qershor 2008 është rritur për 24% realizimi i të hyrave krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2007. Kjo ka ardhur si rezultat i rritjes të të hyrave nga lëshimi i lejeve të ndërtimit për 41% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2007, të rritjes së arkëtimit të tatimit në pronë për 23% krahasuar me vitin 2007 etj. Realizimi i buxhetit ka qenë në nivel prej 19%, që është rezultat i kryerjes së procedurave të prokurimit të shumë projekteve kapitale të cilat tanimë kanë filluar të ekzekutohen. Në kuadër të sektorit të zhvillimit ka vazhduar mbështetja ndaj bizneseve dhe bujqësisë.

Në **Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës Civile** është bërë kontraktimi i rregullt i kompanive për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve, në ndriçimin publik, rregullimin e shërbimit të transportit publik, sinjalizimin horizontal dhe vertikal të rrugëve, mirëmbajtjen dhe zgjerimin e sipërfaqeve gjelbëruese si dhe masat tjera në kuadër të emergjencës civile.

Në **Drejtorinë e Urbanizimit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit** është rritur dukshëm efikasiteti i trajtimit të kërkesave dhe lëshimit të lejeve të ndërtimit që ka sjellë rritjen e të hyrave komunale. Kjo drejtori ka përgatitur disa plane të reja rregulluese dhe ka caktuar lokacionet për shumë ndërtime të shkollave dhe objekteve tjera publike. Një projekt me rëndësi është fillimi i hartimit të projektit 'Prishtina e Re' si dhe detyrave projektuese për shumë lagje dhe projekte infrastrukturore.

Në **Drejtorinë e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit** është punuar në realizimin e shumë projekteve kapitale të ndërtimit të shkollave dhe objekteve tjera sportive dhe për rekreacion, ngritjen e cilësisë në arsim, mirëmbajtjen më të mirë të shkollave etj. Gjatë kësaj periudhe ka filluar ndërtimi i shkollave në Lagjen e Spitalit, të Vreshtave, në fshatrat Dabishec, Gillogovicë, Mramor dhe Llukar. Për shumë të tjera janë zhvilluar procedurat e prokurimit. Në kuadër të kulturës dhe sportit, janë mbështetur shumë projekte kulturore dhe sportive.

Në kuadër të **Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale** janë realizuar 20 projekte të infrastrukturës rrugore të bartura nga viti 2007 me vlerë prej 3.39 milion euro dhe ka filluar realizimi i 21 projekteve të reja gjatë këtij viti në vlerë prej 3.16 milion euro.

Në **Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale** është rritur efikasiteti i shërbimeve shëndetësore ndaj qytetarëve. Janë hartuar projekte për konferencën e donatorëve dhe janë implementuar një numër i projekteve kapitale të ndërtimit të ri dhe renovimit të qendrave të mjekësisë familjare.

Drejtoria e Pronës, si drejtori e re komunale, është koncentruar në zgjidhjen e shumë lëndëve pronësore, e cila gjë konsiderohet shumë e rëndësishme për implementimin e projekteve kapitale në Komunën e Prishtinës. Kjo është sidomos e rëndësishme kur kihet parasysh mungesa e hapësirës për ndërtimin e shumë objekteve publike.

2. AKTIVITETET E KABINETIT TË KRYETARIT TË KOMUNËS

Aktivitete e Kryetarit të Prishtinës sa i përket qeverisjes së Prishtinës nga data 3 janar 2008 deri me 30 qershor 2008 janë paraqitur në vijim. Të dhënat që mbështesin këto aktivitete janë paraqitur në shtojcën I të këtij raporti.

I. Qeverisja komunale dhe bashkëpunimi ndërinstitucional:

- Me qëllim të koordinimit të punës dhe rritjes së efikasitetit janë mbajtur rreth 56 aktivitete me zyrtarë komunal,
- Vizita në terren për inspektimin e punimeve infrastrukturore rreth 13,
- Takime, koordinim dhe udhëheqje të grupeve punuese, këshillit të drejtorëve, mbledhje të asamblesë, mbledhje të komitetit për politikë dhe financa në takime formale dhe jo formale, rreth 57
- Takime konsultative individuale me drejtorët për çështje specifike të drejtorive, janë mbajtur rreth 72 takime,
- Bashkëpunimi dhe koordinimi me institucione, organizata, ndërmarrje publike dhe administrate publike, lokale, rajonale dhe qendrore, janë mbajtur rreth 35 aktivitete,
- Takime dhe koordinim me përfaqësues të partive politike të nivelit lokal dhe qëndror, janë mbajtur rreth 28,
- Takim me institucionet qendrore 51,
- Takime dhe aktivitete jashtë zyrës së kryetarit me qëllim të përfaqësimit të interesit të komunës janë mbajtur 20,
- Kryetari ka marrë pjesë në ceremoni zyrtare vendore si dhe të prezencës ndërkombëtare, ceremoni festive dhe raste përkujtimore në 84 raste

II. Transparenca komunikimi dhe përfshirja e qytetarëve në qeverisje si objektive programor është realizuar nëpërmjet aktiviteteve, politikave dhe masave të mëposhtme:

- Pjesëmarrje në konferenca dhe seminare me qëllim të prezantimit të punës dhe të realiteteve të komunës në 49 raste
- Me qëllim të identifikimit të nevojave dhe të kërkesave të qytetarëve si dhe të përfshirjes së tyre në qeverisjen e Prishtinës janë mbajtur 57 takime individuale dhe grupe
- Takime, prezantime publike si dhe debate publike janë mbajtur në 30 raste

- Me qellim të rritjes së transparencës dhe të qasjes sa më të madhe të medias në punën e kryetarit janë mbajtur 10 aktivitete me gazetar (konferenca, takime formale dhe jo formale)
- Me qellim të identifikimit të mundësive për lehtësimin e punës së gazetarëve janë mbajtur 7 takime individuale me drejtues të medias
- Shoqëria civile si partner në qeverisje është konsultuar dhe angazhuar nëpërmjet pjesëmarrjes në komisione komunale si dhe në 18 takime në formën e konsultimit direkt
- Përfaqësues të sindikatave janë konsultuar në takime formale të paktën 2 herë
- Komuniteti fetar ka qene i përfshirë në takime dhe konsultime për të trajtuar mundësit e bashkëpunimit dhe të zgjidhjes së problemeve me të cilat ata përballohen, janë takuar dhe konsultuar në 8 raste

III. Siguria publike si objektiv programore është trajtuar me kujdes të veçantë dhe janë arritur suksese të mira sidomos me rastin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës ku ceremonitë e shpalljes dhe të manifestimit qendror janë mbajtur në Prishtinë:

- Kryetari ka qene i përfshire në shume aktivitete, koordinime dhe konsultime me organet e sigurisë në rreth 34 raste
- Koordinim shume i mire me organet e sigurisë për rrënimin e ndërtimeve pa leje

IV. Zhvillimi Ekonomik si prioritet i rëndësishëm në qeverisjen e Prishtinës është konkretizuar me këto aktivitete:

- Angazhimi në hartimin e strategjisë afatmesme zhvillimore
- Bashkëpunimi me institucione financiare vendore dhe ndërkombëtare për të promovuar zhvillimin ekonomik, janë mbajtur 3 takime
- Takime dhe aktivitete të rëndësishme me investitor ndërkombëtar për zhvillimin ekonomik janë mbajtur në 19 raste
- Biznesi lokal është konsultuar dhe angazhuar në aktivitete zhvillimore në mbi 19 raste

V. Bashkëpunimi ndërkombëtar është realizuar në këto forma:

- Me qellim të urimit për marrjen e pozitës së kryetarit dhe për koordinimin e punës për shpalljen e pavarësisë së Kosovës, dhe pastaj për ndarjen e lokacioneve për ambasadat në kryeqytetin e shtetit të ri dhe për deklarimin e përkrahjes për Prishtinën janë mbajtur rreth 46 takime dhe aktivitete me përfaqësues të ambasadave.
- Takime me përfaqësues të UNMIK, OSBE, BE, BB, FMN, CPI, Komision Evropian etj. Janë mbajtur në 27 raste
- Udhëtime zyrtare jashtë vendit janë realizuar në 7 raste

VI. Kabineti i këshilltareve të kryetarit ka qene i përfshirë në shumicën e aktiviteteve të kryetarit si dhe ka pasur detyra specifike:

- Finalizimi i 'Strategjisë afatmesme zhvillimore e Prishtinës 2008-2011' që është aprovuar në Kuvendin Komunal, organizimi i takimit me 14 agjencione të OKB-së që veprojnë në Kosovë për të identifikuar projektet ku këto agjenci mund të kontribuojnë.
- Përgatitja e 9 projekt koncepte të cilat janë dorëzuar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal për financim nga IPA (Instrumenti Para-Hyrës i Bashkimit Evropian).
- Përgatitja e 35 projekt koncepte për Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave për të prezantuar në Konferencën e Donatorëve dhe për përgatitjen e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve.
- Në mungesë të zyrtarit përkatës dhe të kufizimeve për të punësuar staf të ri në komunë, njëri nga Këshilltarët e Kryetarit ka menaxhuar me aktivitetet e zyrës për Integritet

Evropiane. Puna e tij ka konsistuar në koordinimin e të gjitha aktiviteteve komunale që kanë të bëjnë me çështjet e integriteteve evropiane. Janë organizuar shumë aktivitete për nder të Ditës së Evropës më 9 maj, janë trajnuar një numër i zyrtarëve komunal për çështje të integriteteve evropiane, pjesëmarrje në takimet e organizuara nga MAPL dhe institucionet tjera në lidhje me integritet evropiane etj.

- Konsultimi direkt me kryetarin dhe stafin komunal në çështje specifike
- Hartimi i ligjit për kryeqytetin
- Riorganizimi i brendshëm i komunës
- Hartimi i raporteve
- Marrëdhëniet me publikun dhe rritja e transparencës së qeverisjes
- Trajtimi i rregulloreve të brendshme
- Trajtimi i rregulloreve për çështje të planifikimit urban
- Trajtimi i programeve zhvillimore
- Këshilla në hartimi, trajtimin dhe zbatimin e planeve urbane etj.

VII. Rastet e pranuar në zyrën e kryetarit:

- Zyra e kryetarit ka pranuar rreth 767 raste, të gjitha rastet janë dërguar te organet kompetente për procedim

3. ZYRAT

3.1. Zyra ligjore

Gjatë periudhës raportuese janar – qershor 2008, zyra ligjore ka kryer këto aktivitete:

- (i) Ka ofruar shërbime dhe këshilla për zyrtarë të sektorëve dhe drejtorive, për këshilltarë e Kuvendit të Komunës si dhe për shërbyesit civilë në përgjithësi,
- (ii) Ka bashkëpunuar me zyrtarët e komunës dhe me subjekte të tjera lidhur me hartimin e ndryshimeve të Statutit të Komunës dhe në përgatitjen e akteve të tjera të përgjithshme juridike, siç janë rregulloret e ndryshme të miratuara nga Kuvendi i Komunës,
- (iii) Ka hartuar rregulloren e punës së Kuvendit Komunal,
- (iv) Ka hartuar rregulloren e punës dhe kompetencave të komiteteve,
- (v) Ka marrë pjesë në tryezën për decentralizim të mbajtur në Ohër më 28/02/2008-02/03/2008,
- (vi) Ka marrë pjesë në takimet e kolegjiut të zyrtarëve ligjorë të komunave të Kosovës,

3.2. Zyra për integritete evropiane

Si zyrë e re e krijuar në vitin 2008, Zyra për Integritet Evropian koordinon të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me procesin e integriteteve evropiane në kuadër të komunës:

- (i) bashkëpunon me Agjencinë për Integritet Evropian (AIE) në Kryeministri dhe Zyrën për Integritete Evropian (ZIE) në kuadër të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) në koordinimin e aktiviteteve në lidhje me procesin të Integritetit Evropian (IE),
- (ii) koordinon detyrat e Komunës së Prishtinës që burojnë nga Planin e Veprimit të Partneritetit Evropian (PVPE),
- (iii) mbikëqyr aktivitetet e drejtorive dhe zyrave në Komunën e Prishtinës që burojnë nga PVPE si dhe dokumentet tjera strategjike të MAPL dhe Qeverisë së Kosovës,
- (iv) sipas kërkesës së MAPL dhe AIE, përgatit raporte të rregullta për qëllime të monitorimit të aktiviteteve lidhur me PVPE,

- (v) mbikëqyrë zhvillimin e rregulloreve në komunë për të siguruar që ato janë në përputhje me standardet evropiane etj.

ZIE në komunë ka kryer këto aktivitete gjatë periudhës Janar – Qershor 2008:

- (i) Ka marrë pjesë rregullisht në takimet e organizuar nga Zyra për Integritet Evropian në MAPL në lidhje me procesin e integritetit evropian dhe ka raportuar tek Kryetari i Komunës.
- (ii) Gjatë periudhës 20-22 mars 2008 dhe 14 maj 2008, ZIE ka koordinuar trajnimin për politikën e Bashkësisë Evropiane të 6 zyrtarëve komunal të mbajtur nga ekspertët e Fondaconit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).
- (iii) Më datë 17 Prill 2008, ZIE ka organizuar një takim në komunë me zyrtarët për Integritet Evropian të të gjitha komunave të Kosovës dhe zyrtarëve nga MAPL ku është diskutuar drafti i Planit për Partneritet Evropian (PVP) i përgatitur nga Qeveria e Kosovës. Në këtë takim janë diskutuar dhe është arritur pajtimi për aktivitetet që do organizojnë komunat në lidhje me shënimin e Ditës së Evropës më 9 maj.
- (iv) Më datë 15 Prill 2008, ZIE ka marrë pjesë në takimin e kolegjiut të zyrtarëve të komunave të Kosovës për integritet evropian ku janë zgjedhur organet drejtuese të këtij kolegjiut. Zyrtari i Integritet Evropian i Komunës së Prishtinës është zgjedhur anëtar i kryesisë të këtij kolegjiut.
- (v) ZIE në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit, Kulturës dhe Sportit ka organizuar aktivitetet për shënimin e Ditës së Evropës më datë 9 maj 2008. Janë organizuar këto aktivitete: (i) të gjitha shkollat e Prishtinës kanë organizuar një orë mësimi për ditën e Evropës, (ii) është organizuar një debat me nxënës lidhur me Integritet Evropian, (iii) janë vendosur shenjat e BE-së nëpër rrugët e qytetit, (iv) në bashkëpunim me shkollat janë organizuar koncerte, (v) është organizuar maratona në vrapim (me fanella të BE-së).
- (vi) Gjatë muajit qershor 2008, ZIE ka marrë pjesë aktive në përgatitjen dhe diskutimin e draftit të rregulloreve së punës së 'Kolegjiut të zyrtarëve komunal për integritet evropian'.

3.3. Zyra për auditim të brendshëm

Gjatë periudhës gjashtëmuajore janar-qershor 2008, zyra e auditorit të brendshëm ka finalizuar tri raporte audituese:

- (i) Menaxhimi i të hyrave vetanake në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (auditimi është bërë për periudhën prej 01/01/2006 deri më 31/12/2006),
- (ii) Procedurat e rekrutimit në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme (njësia e personelit): (auditimi është bërë për periudhën prej 01/01/2005 deri më 31/12/2007),
- (iii) Buxheti për minoritete në zyrën në Graçanicë (auditimi është bërë për periudhën prej 01/01/2007 deri më 31/12/2007). Në këtë auditim kanë marrë pjesë pesë auditor nga pesë komuna të Kosovës si dhe një këshilltar ndërkombëtarë. Ky auditim është bazuar në pilot auditimin e organizuar nga projekti i BE-së 'Përkrahja e mëtutjeshme e kontrollit të brendshëm të financave publike dhe auditimit të brendshëm' që menaxhohet nga AER-i. Udhëheqës i ekipit të auditimit ka qenë auditori i brendshëm i Komunës së Prishtinës.

Gjatë kësaj periudhe raportuese është formuar 'Komisioni i auditimit të brendshëm' siç parashihet me 'Ligjin për Auditim të Brendshëm'. Ky komitet ka këto detyra: (i) aprovon planin e punës të zyrës së auditimit dhe (ii) mbikëqyrë implementimin e rekomandimeve që nxjerrë auditori i

brendshëm në raportet e auditimit. Tani zyra e auditimit të brendshëm në komunë është kompletuar me stafin adekuat: drejtori i zyrës që është njëkohësisht auditor i brendshëm dhe dy auditor të tjerë dhe janë krijuar kushtet për punë shumë më intensive të kësaj zyreje.

3.4. Zyra për marrëdhënie me publikun

Zyra për Marrëdhënie me Publikun (ZMP) gjatë periudhës janar- qershor 2008 ka bërë një aktivitet të dendur të punëve sipas përgjegjësive dhe rolit që ka. Kjo zyrë çdo ditë kontaktohet dhe kontakton mediat e shkruara dhe elektronike që veprojnë në Prishtinës si dhe ka raportuar rregullisht për punët dhe aktivitetet e Komunës së Prishtinës. ZMP ka përcjell të gjitha takimet protokollare të Kryetarit të Komunës, mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të Këshillit të Dejtorëve dhe të Komitetit për Politikë dhe Financa. Përmes komunikatave për media është informuar opinioni publik për të gjitha këto takime.

ZKP ka distribuuar për media numër të madh informatash, lajme, ftesa, komunikata, reagime dhe kumtesa për opinion, të cilat janë plasuar edhe në ueb-faqen e Komunës së Prishtinës dhe në intranet. Gjatë kësaj periudhe janë organizuar 11 konferenca për medie, të cilat janë përcjell nga pothuajse të gjitha mediat elektronike dhe të shkruara. Po ashtu, ZMP në bashkëpunim me OJQ "ATRC" ka organizuar debatet publike me grupe të interesit për Statutin e ri të Komunës. ZMP ka zhvilluar edhe kampanjën për debatin publik me qytetarë.

Është bërë akreditimi i gazetarëve që mbulojnë aktivitetin e komunës së Prishtinës. ZMP ka bashkëpunuar me Asociacionin e komunave, OJQ-të, KFOR-in, OSBE-në, dhe institucionet tjera vendore. ZMP ka përcjellur vazhdimisht shtypin ditor dhe mediat elektronike dhe ka veçuar informatat mbi Komunën e Prishtinës, të cilat i ka ruajtur dhe arkivuar. ZMP është përkujdesur edhe për funksionimin e ueb-faqes së Komunës së Prishtinës të cilën e ka freskuar me materiale. Ueb-faqja pritet të ridizajnohet dhe të eliminohen mangësitë eventuale.

Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kjo zyrë ka pasur vëllim më të shtuar të punëve të gjitha segmentet. Përkrahja e mediave të shkruara dhe elektronike në mbulimin e aktiviteteve të komunës cilësohet më kënaqshme, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Komunës së Prishtinës i është rezervuar hapësirë e kënaqshme në tri televizionet dhe në të gjitha gazetaret ditore për t'i plasuar të arriturat dhe aktivitetet. Janë mbuluar nga mediat përgjithësisht të gjitha aktivitetet e kryetarit dhe të këshillit të drejtorëve: rrënimet e objekteve pa leje, largimi i shitësve ambulant, rregullimi i infrastrukturës rrugore dhe asaj shkollore etj.

Përkushtim i ZMP mbetet: informimi i drejtë dhe me kohë i qytetarëve për punën dhe aktivitetet e udhëheqjes komunale, ngritja e imazhit dhe besueshmërisë së komunës në raport me qytetarët, zbatimi i planit të veprimt për transparencë, përgatitja dhe botimi i fletushkave, apo i një gazete për informim të qytetarëve, organizimi i seminareve për gazetarë që mbulojnë punën e Komunës së Prishtinës për tema të ndryshme, organizim i tryezave, debateve për tema të ndryshme që kanë të bëjnë me qeverisjen lokale etj.

3.5. Zyra pritëse

Zyra pritëse gjatë periudhës raportuese ka pranuar 16,437 lëndë. Prej tyre, 74% janë zgjidhur ndërsa për të tjerat janë informuar palët. Tabela në vijim paraqet në detale numrin dhe natyrën e këtyre lëndëve.

Drejtoritë	Të pranuar	Të refuzuar	Të miratuara	Të hedhura poshtë	Kushte Urbanistik	Njoftime	Informim	Përgjigje	Leje ndërtimi	Konkluzë	Të pakryera
1. Administrata	1,029	36	721	-	-	13	6	4	-	-	249
2. Shëndetësi dhe mirëqenie sociale	316	44	136	-	-	40	-	2	-	-	94
3. Arsim, sport dhe kulturë	453	72	142	-	-	51	21	32	-	-	96
4. Financa, ekonomi dhe zhvillim	9,352	165	8,448	17	-	13	2	-	-	-	707
5. Urbanizëm, kadastrë dhe mbrojtje të mjedisit	3,135	119	2,218	9	87	62	188	-	22	-	440
6. Infrastrukturë Lokale	53	-	-	-	-	21	-	-	-	-	32
7. Shërbime publike dhe emergjencë civile	2,060	3	564	-	-	294	14	13	-	-	1,172
8. Pronë	39	-	4	-	-	-	-	-	-	-	35
Gjithsej :	16,398	439	12,229	26	87	494	231	51	22	0	2,790*

* Shpjegim: Shumica nga këto lëndë kanë arritur në ditët e fundit të muajit qershor dhe në ndërkohë janë kryer.

3.6. Zyra për ankesa

Gjatë periudhës janar – qershor 2008, zyrës për ankesa i janë adresuar gjithsej 94 ankesa, të cilat janë shqyrtuar në procedurë administrative dhe të cilat janë zgjidhur në mënyrën si vijon:

- 64 ankesa refuzuar si të pabaza 64 (prej të cilave 53 kanë qenë për Drejtorinë e Urbanizmit Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, 6 ankesa për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës Civile dhe 5 ankesa për Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale),
- 8 ankesa të bazuara janë aprovuar (prej të cilave 7 kanë qenë për Drejtorinë e Urbanizmit Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe 1 për Drejtorinë e Arsimit, Kulturës dhe Sportit),
- 7 ankesa janë përcjell në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për kompletim të mëtejme dhe shqyrtim,
- 15 ankesa të tjera (prej të cilave 10 janë përcjellur në drejtorië kompetene dhe 5 janë kthyer përgjigjet nga zyra për ankesa).

3.7. Zyra e avokaturës publike

Funksioni dhe kompetencat e kësaj zyre janë të rregulluara dhe të përcaktuara me ‘Ligjin mbi Avokaturën Publike’. Gjatë periudhës raportuese janar- qershor 2008, kjo zyrë ka bërë përfaqësimin juridik të Komunës në institucionet gjyqësore dhe në institucionet tjera me qëllim të mbrojtjes së interesit juridik dhe pasuror të komunës në gjithsej 390 seanca të ndryshme gjyqësore. Në këto seanca janë shqyrtuar gjithsej 183 lëndë, prej të cilave:

- lëndë të natyrës civile 115
- Konteste nga marrdhënia e punës 8
- Konteste administrative 20
- Procedura të natyrës penale 15
- Procedura të jashtëzakonshme 10
- Konteste civile që për objekt kanë pasur kompenzimin e borxhit 15

Nga gjithsej këto lëndë, janë përfunduar 36 prej tyre ndërsa të tjerat janë në procedurë. Prej lëndëve të përfunduara:

- 13 kanë përfunduar në shkallë të parë (prej të cilave 10 janë në favor të komunës ndërsa tri vazhdojnë me ankesa),
- 11 kanë përfunduar në shkallë të dytë (prej të cilave 6 janë vendosur në favor të komunës dhe 5 vazhdojnë me revizionim),
- 6 janë raste penale për uzurpime arbitrare që janë vendosur në favor të komunës dhe
- 6 janë aktvendime të procedurës jashtëkontestimore-banesave.

3.8. Zyra për çështje gjinore dhe mundësi të barabarta

Gjatë periudhës janar-qershor 2008, zyra për çështje gjinore dhe mundësi të barabarta ka punuar në:

- Hulumtimin, grumbullimin e të dhënave dhe caktimin e prioriteteve për këtë vit,
- Takime me OJQ në fushën e bashkëpunimit në të ardhmen,
- Organizimi i tryezës 'Roli i femrës në pozita vendi marrëse',
- Bashkëpunimi me OJQ nga zonat rurale në kuadër të projektit 'Qendre Informative për Gratë' ku janë mbajtur tryeza me OJQ të grave, takime me gra nga viset rurale etj.
- Nga muaji prill është formuar edhe Njësia për të drejtat e njeriut (NJDNJ), është caktuar koordinatori, kanë filluar trajnimet dhe po përgatitet plani i punës,
- Ka marrë pjesë në hartimin e programit të Kosovës për Barazi Gjinore,
- Ka mbajtur takime me Agjencionin për Barazi Gjinore,
- Ka mbajtur takime me Ministrinë e Pushtetit Lokal,
- Ka organizuar debate me gratë në fushën e shëndetësisë,
- Ka organizuar tryezën e rumbullaket me Gratë e të gjitha komuniteteve
- Ka mbajtur mbledhje të rregullta mujore me qendrën rajonale të punësimit,

3.9. Zyra për teknologji informative

Zyra për teknologji informative (TI), gjatë periudhës janar-qershor 2008 ka udhëhequr dhe kontrolluar punën e sistemit të teknologjisë informative me qëllim të zbatimit të standardeve dhe ofrimit të shërbimeve sa me cilësore dhe shpërndarjes së informimit mbi teknologjinë informative. Në veçanti, kjo zyrë:

- (i) ka zbatuar politikën e harduerit/softuerit kompjuterik dhe të qasjes në e-mail, internet dhe intranet,
- (ii) ka bërë mirëmbajtjen e infrastrukturës për internet/intranet, shtrirjen e kablove, kyçjen e tyre në kabinetet e switch-ave, dhe përcaktimi i porteve,
- (iii) ka krye shërbime softuerike dhe harduerike për shfrytëzuesit komunal,
- (iv) është kujdesur për siguri në teknologji informative,
- (v) në dhomën e serverëve janë vendosur 3 Serverë: Serveri kryesor i intranetit, Serveri ndihmësi intranetit dhe Proxy Serveri.
- (vi) me qëllim të rritjes së sigurisë në rrjet dhe për funksionim më të mirë të Serverëve, është bërë instalimi i MS Windows 2003 Server në të dy serverët e intranetit, instalimi i serverëve HP dhe DELL
- (vii) është vendosur versioni i ri i intranetit i cili mundëson komunikimin e shpejtë dhe efikas dhe menaxhimin e shpejtë të kërkesave të qytetarëve.
- (viii) është dizajnuar aplikacioni softuerik për Drejtorinë e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit i bazuar në web teknologjinë, i cili është i lehtë për përdorim. Ky aplikacion është punuar nga zyrtarët e teknologjisë informative në komunë dhe do të kryejë këto

funksione: regjistrimin e kompanive, shtypja e lejeve të punës për biznese, shtypja e aktvendimeve për licencë të biznesit, gjenerimi i raporteve në bazë të fushave të ndryshme të kërkimit, dizajnimi i tabelave për tarifatat vjetore për ushtrimin e veprimtarive etj. Aplikacioni do të integrojë fillimisht edhe të dhënat të cilat do të jenë në dispozicion nga ana e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

3.10. Zyra për kthim

Zyra për kthim është angazhuar që komunitetet minoritare të kenë qasje në shërbimet publike. Vëmendje të veçantë i është kushtuar të kthyerve dhe atyre që kanë kërkuar të kthehen. Gjatë periudhës janar-qershor 2008, zyra për kthim ka pasur 24 takime me përfaqësuesin e UNMIK-ut për Komunën e Prishtinës si dhe 3 takime me Grupin Komunal Punues të Kthimeve (GPKK) në të cilat janë shqyrtua këto çështje:

- (i) Informimi mbi punën e Nëngrupeve Punuese për kthimin e të zhvendosurve,
- (ii) Informimi mbi punën e Këshillit komunal të lokalizimit dhe integritit,
- (iii) Informimi me para vizitat në teren për identifikimin e pronave të zhvendosurve,
- (iv) Informimi me punën e zyrtarit komunal të kthimeve,
- (v) Njoftimi mbi takimet informative pas vizitave jashtë vendit, në vendet ku tani banojnë të zhvendosurit në Serbi,
- (vi) Ka shqyrtuar kërkesat, ankesat dhe propozimet e përfaqësuesve të Shoqatave të zhvendosurve, të bashkësive multietnike dhe organizatave ndërkombëtare.
- (vii) Shqyrtimi i disa projekt dokumenteve.
- (viii) Elaborimi i strategjisë komunale të kthimit.

Gjatë kësaj periudhe raportuese janë organizuar 5 takime me zyrtarë të UNHCR ku janë diskutuar: kërkesat dhe gjendja e komunitetit Ashkali dhe Romë, gjendjen e familjeve serbe të cilët jetojnë në qytetin e Prishtinës, strategjisë komunale për kthime 2008, koordinimi i punëve në mesë të zyrtareve për kthime dhe organizatave tjera ndërkombëtare, aranzhimi i objektivave të përbashkëta lidhur me të zhvendosurit, puna e nëngrupit punuese për kthime e të zhvendosurve serbë në fshatin Kolovicë (para vizitat, vizitat dhe takimet informative pas vizitave), procesi i lokalizimit (pengesat, sfidat, shqetësimet dhe rekomandimet) etj.

Po ashtu janë organizuar 10 takime të 'Komitetit për komunitete' në të cilat janë shqyrtuar këto çështje: raportet e punës të zyrtarëve të syrës së komuniteteve në Graqanicë, njoftimi me punën e zyrtarëve të zyrës komunale të kthimit, kërkesat dhe ankesat e pjesëtarëve të komuniteteve, gjendjen e tyre ekonomike dhe sociale, objektivat e përbashkëta të kthimit etj. Janë organizuar edhe takime të shumta me përfaqësues të organizatave dhe institucione të ndryshme si UNMIK, UNDP, OSCE, IOM, Mercy Corps, MAPL, MKK, DRC, KFOR, SHPK etj. UNDP ka ndërtuar/riparuar disa shtëpi për kthimin e personave të zhvendosur. Në bashkëpunim me UNHCR/DRCm KFOR dhe SHPK, janë organizuar 20 vizita pronave, shtëpive dhe banesave të të zhvendosurve dhe të kthyerve Serb, Ashkali dhe Romë. Po ashtu janë vizituar edhe 6 familje të kthyer në pronat e tyre të komuniteteve të ndryshme. Janë organizua 3 takime të 'Këshillit Komunal të Lokalizimit' ku janë shqyrtua: procesi i përparimit të lokalizimit. Aktivitetet mujore, progresi i arritur etj. Janë vizituar disa familje serbe që jetojnë në qytetin e Prishtinës.

Janë organizua 4 takime të nëngrupeve punuese në të cilat janë shqyrtuar: kthimi i të zhvendosurve në Bashkësinë e D. Jugoviqit si në fshatin Leban, Brnicë të Epërme, Brnicë të Poshtme, Kolovicë, në fshatrat Kishnicë e Sushicë, kushtet ekonomike, shëndetësore, arsimore të sigurisë dhe të

infrastrukturës sidomos për ata që janë të vendosur në kontejnerë etj. Janë organizua 3 Takime të nëngrupeve punuese në të cilat janë shqyrtuar: kKthimi i të zhvendosurve në fshatin Kolovicë, bashkëpunimi me Habitatin (tani AKP) lidhur me lirim të pronave të uzurpuara, inicimi i dialogut multietnik për kthimin e Serbëve në fshatin Kolovicë. Zyrtarët për kthime kanë marrë pjesë në 8 trajnime të cilat i ka organizua UNHCR dhe UNMIK.

Gjatë periudhës janar-qershor 2008, nëpërmes zyrës për kthime kanë kërkuar të kthehen familjet të zhvendosur nga fshati Kolovicë (2 familje Serbe, 2 familje Rome, 3 Familje Ashkali dhe 1 familje Boshnjake). Janë organizua 2 para vizita për identifikimin e pronave, shtëpive dhe banesave të zhvendosurve Serb, Ashkali dhe Romë. Gjatë kësaj periudhe, në Komunën e Prishtinës janë kthyer 5 familje të zhvendosura (2 familje Serbe, 2 familje Ashkali dhe 1 familje Rome).

3.11. Zyra për komunitete

Zyra e komuniteteve është kujdesur për komunitetet joshqiptare në Komunën e Prishtinës në pajtim me kompetencat që ka dhe në koordinim me eprorët dhe shërbimet kompetente. Në pjesën e administratës së përgjithshme kjo zyrë ka punuar në pajtim me rregullativat në fuqi duke promovuar tolerancën dhe barazinë e të gjithëve. Mjetet e alokuara financiare janë shfrytëzuar në harmoni me buxhetin dhe me procedurat komunale. Në ndarjen e mjeteve për investime kapitale rëndësi i është dhënë sidomos fshatrave.

Zyra për komunitete ka mbajtur mbledhje të rregullta me Administratorin e Komunës. Zyra ka pasur aktivitete të rregullta dhe kontakte sipas kërkesës së përfaqësuesve të fshatit, përfaqësuesve të bashkësive, të ndërmarrjeve, të policisë, të UNMIK-ut, të KFOR-it, të OSCE-së, të organizatave joqeveritare e të tjerë.

Shërbimi i administratës së përgjithshme dhe i financave ka nxjerr planin për vitin vijues 2008 dhe është kujdesur për kontratat e punonjësve, të cilëve u janë vazhduar kontratat deri më 31/12/2008. Numri i personelit mbetet i njëjtë me vitin paraparak (22). Sektori i financave ka punuar në bazë të koordinimit të direktivave të Drejtorisë së Financave dhe Zhvillimit Ekonomik. Mjetet e parapara për zyrën e komuniteteve për vitin 2008 janë si vijon:

-Për projekte kapitale nga grantet	140,000 €
-Për projekte kapitale nga të hyrat	300,000 €
-Për mallra dhe shërbime	97,756 €
-Për paga	58,000 €

Ka ngecje në realizimin e buxhetit në muajt e parë të këtij viti sidomos në projektet kapitale. Gjatë kësaj periudhe raportuese, për projekte kapitale janë shpenzuar vetëm 18,869 € Për mallra dhe shërbime janë shpenzuar 23,554 € ndërsa për paga janë shpenzuar 23,419 €

Në shërbimet publike realizimi i shumë projekteve të parapara nuk ka filluar pak për arsye të tensioneve politike të krijuara pas shpalljes së pavarësisë e pjesërisht edhe për arsye procedurale. Gjatë kuartalit të parë të vitit 2008 është realizuar projekti “Punimi i rrethojës në terrenin e futbollit në Graçanicë” i cili ka filluar në vitin 2007. Në kuartalin e dytë të vitit 2008 ka filluar realizimi i projektit “Pastrimi i deponive të egra të mbeturinave”. Është përgatitur dokumentacioni për një numër projektsh që janë në procedurë. Inspekcioni komunal në të cilin punon një inspektor ka kryer vizita në teren për pengimin e shitjes në rrugë, kontrollin e shfrytëzimit të ujit të pijshëm (i ndihmuar nga SHPK), pengimin e uzurpimit të tokës komunale etj. Janë bërë përpjekje rreth vendosjes së personave me gjendje të vështirë materiale dhe të shpërngulurve intern në kontejnerë

në dy qendra kolektive (Voçar dhe Padalishtë). Janë mbajtur kontakte me OJQ-të dhe me organizatat tjera për sigurimin e ndihmës humanitare dhe të ndihmës tjetër për familjet e rrezikuara materialisht.

Shërbimi i arsimit dhe i shëndetësisë në bashkëpunimin me Drejtorinë për Arsim dhe Kulturë ka realizuar detyrat lidhur me funksionimin e shkollave me mësim në gjuhën serbe. Komisionet e përbashkëta kanë vizituar të gjitha institucionet arsimore edukative që i mbulon kjo zyrë (12 shkolla) dhe i ka krahasuar listat e pagave të Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës me personat e angazhuar në shkollat e përmendura. Zyra për komunitete ka ndërmjetësuar në mes të OJQ-ve (IOM) dhe drejtorëve të shkollave që të sigurohen donacione. Kështu, objekti i shkollës fillore “Mbreti Millutin” në Graçanicë është renovuar nga IOM-it. Si në sektorin e arsimit edhe në atë të shëndetësisë, bashkëpunimi qendrave shëndetësore dhe i zyrës sonë nuk ishte në nivel të duhur. Ankesat për ngecje të transportit të barërave nga ana e Shërbimit Doganor i kemi orientuar në Zyrën e UNMIK-ut, që i ka marrë këto probleme dhe ka ndihmuar në zgjidhjen e tyre me Shërbimin Doganor.

Në kulturë, rini dhe sport janë realizuar disa projekte. IOM ka financuar realizimin e projektit ‘Sanimi i dëmeve në sallën e fiskulturës dhe adaptimi i repartit të sportit për sporte të vogla pranë Sh.F. Sveti Sava në Sushicë’. Me rastin e shënimit të javës së ‘Sveti Savës’ është mbajtur një varg i manifestimeve kulturore. Zyra ka marrë pjesë në organizimin e manifestimit ‘Thesari shpirtëror serb’, që është mbajtur në shtëpinë e kulturës në Graçanicë. Është realizuar kërkesa e romëve për organizimin e programit kulturor-artistik dhe të aktiviteteve sportive me rastin e ‘Ditës botërore të Romëve’ në Graçanicë. Në parkingun qarkullues të SHPK-së në Graçanicë është organizuar gara e fëmijëve me emrin ‘Çka di për trafikun’, ku kanë marrë pjesë 20 fëmijë serbë, 20 shqiptarë dhe 10 fëmijë romë. Në Plemetin me rastin e ‘Ditës botërore të refugjatëve’ më 20/06/2008 është mbajtur manifestimi për fëmijë i organizuar nga UNHCR dhe MERCY CORPS. Është punuar për koordinimin me OJQ-të lokale me rastin e aplikimit për projekte financiare në ftesat e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Në Graçanicë ka filluar realizimi i projektit ‘Ndërtimi i sallës ballon’ që financohet nga Ministria e Kthimit dhe Komuniteteve.

3.12. Departamenti i prokurimit

Departamenti i Prokurimit gjatë periudhës gjashtë mujore janar –qershor 2008 fillimisht ka bërë planifikimin e prokurimeve për vitin 2008 sipas planeve të Drejtorive dhe ka dorëzuar në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik të Kosovës sipas llojeve të prokurimeve përfshirë furnizime, shërbime dhe punë.

Gjatë kësaj periudhe sipas evidencës së listës së prokurimeve janë shpallur 166 aktivitete të Prokurimit nga të cilat janë kontraktuar 89 kontrata në mes të Komunës së Prishtinës dhe Operatorëve – Kontraktuesve. Të Anuluara janë 58 aktivitete të prokurimit nga mungesa e tri ofertave të përgjegjshme sipas Ligjit të Prokurimit Publik. Në procedurë janë 19 aktivitete të prokurimit që janë në vlerësim. Janë bërë 4 kërkesa për aprovim të procedurave të negociuara në Agjencinë e Prokurimit Publik nga të cila 2 janë aprovuar ndërsa dy janë refuzuar. Sa i përket ankesave të operatorëve në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik në vendimet e Departamentit të Prokurimit, gjatë kësaj periudhe është paraqitur 1 kërkesë e tillë.

Vlera e përgjithshme e projekteve për punë është 3.469.436,26 € për mallra 1.250.441,18 € dhe për shërbime 605.902,33 € Vlera e përgjithshme e projekteve të kontraktuara gjatë periudhës janar-qershor 2008 është 5.325.779,77 €

4. DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT

4.1. Sektori i punëve të përgjithshme dhe juridike

Gjatë periudhës raportuese janar – qershor 2008 në kuadër të këtij sektori janë rregulluar, sistemuar dhe ruajtur dokumentacionet, gjegjësisht dosjet personale të shërbyeseve civilë. Po ashtu janë përpiluar kontrata të punës, janë përgatitur vendime për pushim vjetor, vendime për pushim të lehonisë, vendime për ndërprerje të marrëdhënies së punës, vërtetime të ndryshme sipas kërkesave të shërbyeseve civilë, janë përpunuar dhe janë futur në sistemin kompjuterik të dhënat personale të shërbyeseve civilë, është bërë fotokopjimi dhe shumëzimi i materialeve të ndryshme për nevojat e të gjitha drejtorive të Komunës etj.

Në evidencat e Shërbimit për marrëdhënie pune (gjendja më 30.6.2008), janë të regjistruar gjithsej 653 shërbyes civilë, ndërkohe që gjatë kësaj kohe janë pensionuar 9 shërbyes civilë. Komisioni disiplinor ndërkaq ka zhvilluar procedura e përgjegjesisë disiplinore kundër 9 shërbyeseve civilë, ku janë shqiptuar masat disiplinore si: ndalesë e rritjes së pagës për 5 shërbyeseve civilë, ndërprerje e marrëdhënies së punës për 3 shërbyesve civilë, ulje e pozitës për 1 shërbyesi civil.

Duke u bazuar në punën jo në nivel të Sektorit të Inspeksionit, në veçanti të inspeksionit të ndërtimtarisë, Kryetari i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 29/05/2008 ka marrë vendim për reformimin e këtij sektori. Nëntë inspektorëve që iu ka skaduar kontrata më 30/06/2008 dhe që nuk kanë treguar rezultate nuk ju kanë vazhduar kontratat e punës. Si rezultat është hapur konkursi për 6 inspektorë të ndërtimtarisë dhe 3 inspektorë komunal. Sipas konkursit publik janë pranuar inspektorët komunal, ndërsa për punët e inspektorëve të ndërtimtarisë është kontraktuar operatori 'Park Projekt'. Ky operatorë ka për obligim që të bëjë zbulimin dhe rrënimin e ndërtimeve pa leje, pas raportimit që bënë në sektorin e inspeksionit të ndërtimit.

4.2. Sektori i shërbimeve të Kuvendit

Sektori i shërbimeve të Kuvendit gjatë periudhës raportuese ka përgatitur materialet për mbledhje, punët rreth përkthimit, lekturimit dhe shpërndarjes së materialeve, përpunimi i ekstrakteve të ndryshme nga mbledhjet e mbajtura, si dhe janë përgatitur rregullore, vendime dhe akte të tjera të miratuara në Kuvend. Gjatë periudhës raportuese janë mbajtur :

- 10 mbledhje të rregullta të Këshillit të Drejtorëve;
- 6 mbledhje të rregullta të Kuvendit dhe 1 mbledhje e jashtëzakonshme;
- 3 mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa;
- 6 mbledhje të Komitetit të Komuniteteve;
- 1 mbledhje e Komitetit për Ndërmjetësim;
- 2 mbledhje e Komitetit për Planifikim Urbanizëm dhe Ndërtim;
- 10 mbledhje të Komitetit për Shëndetësi Mirëqenie Sociale dhe Strehim;
- 5 mbledhje e Komitetit për Arsim Kulturë dhe Sport;
- 7 mbledhje të Komitetit për Zhvillim Ekonomik;
- 7 mbledhje e Komitetit për Shërbime Publike;
- 6 mbledhje të Komitetit për Pronë;

- 2 mbledhje e Grupit komunal për kthim;
- 1 mbledhje – tubim me qytetarë;
- 1 mbledhje e Këshillit komunal për parandalimin e krimit dhe
- 1 mbledhje – tubim me qytetarë.

Gjatë periudhës raportuese Janar – Qershor 2008, Kuvendi ka miratuar 2 rregullore dhe 61 vendime të ndryshme.

4.3. Sektori i bashkësive lokale

Zyrat e bashkësive lokale gjatë periudhës gjashtë mujore sipas kërkesave të palëve kanë lëshuar vërtetime të llojeve të ndryshme, si dhe shkresa të tjera zyrtare:

- Vërtetime për rregullimin e të drejtës në asistencë sociale 269
- Vërtetime për qytetarët tanë që përkohësisht jetojnë në botën e jashtme që iu shërbejnë si dëshmi se janë mbajtës të familjarëve të tyre në Kosovë 48
- Vërtetime për të dëshmuar vendbanimin me qëllim të regjistrimit në Zyrën e regjistrimit civil 52
- Vërtetime për të dëshmuar vendbanimin me qëllim të regjistrimit të automjeteve 163
- Vërtetime për kalim tranzit të qytetarëve tanë nëpër territorin e Serbisë 103
- Vërtetime për të dëshmuar vendbanimin me qëllim të regjistrimit të nxënësve në shkolla fillore dhe të mesme 17

4.4. Sektori teknik

Në kuadër të këtij sektori funksionojnë 4 shërbime. Ky sektor gjatë kësaj periudhe ka kryer këto punë dhe detyra:

- Është bërë sigurimi dhe mirëmbajtja e objekteve të Komunës, përfshire këtu edhe mirëmbajtjen e zyrave dhe sallës së Kuvendit të Komunës,
- është bërë edhe mirëmbajtja e teknologjisë informative dhe e rrjetit telefonik brenda objekteve të Komunës,
- ngjyrosja dhe rregullimi i disa zyrave brenda objektit të Komunës.

Gjithashtu kësaj periudhe, automjetet e Komunës, gjatë kryerjes së punëve zyrtare kanë regjistruar gjithsej 202,206 km të kaluara, ku janë harxhuar gjithsej 27,978 litra karburante. Krahasuar me periudhën janar-qershor 2007, në periudhën e njëjtë gjashtëmujore të vitit 2008, janë regjistruar 80,769 km më pak të kaluara ose 40% më pak, dhe 8,683 litra derivate më pak të harxhuara ose 30% më pak se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

4.5. Sektori i gjendjes civile

Gjatë periudhës raportuese, janë realizuar këto punë dhe detyra :

- regjistrime të reja në Librin Amzë të të Lindurve (LAL) 5,250 (6 më pak se në periudhën e njëjtë të vitit 2007),
- regjistrime të mëvonshme në LAL 5,389 (390 më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit 2007),
- regjistrime të reja në Librin Amzë të Martesave (LAM) 674,
- regjistrime të mëvonshme në LAM 645 (që janë 128 më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit 2007),

- Regjistrime të reja në Librin Amzë të të Vdekurve (LAV) 817 (që janë 106 më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit 2007),
- Regjistrime të mëvonshme në LAV 382 (që janë 75 më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit 2007),
- Regjistrime speciale në LAL 811,
- Regjistrime speciale në LAM 107,
- Regjistrime speciale në LAV 30,
- Çertifikata të lindjes 16,030 (830 më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit 2007),
- Çertifikata martesore 4,566 (250 më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit 2007),
- Çertifikata të vdekjes 3,051 (563 më pak se në periudhën e njëjtë të vitit 2007),
- Çertifikata të statusit martesor 1,593 (163 më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit 2007),
- Vërtetime që personi është në jetë 596 (125 më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit 2007),
- Deklarata të bashkësisë familjare 2,356,
- Çertifikata të lindjes për qytetarë kosovar të lindur jashtë vendit 2,149,
- Çertifikata të martesës për qytetarë kosovar të martuar jashtë vendit 172,
- Çertifikata të vdekjes për qytetarë kosovar që kanë vdekur jashtë vendit 63.

5. DREJTORIA E FINANCAVE, EKONOMISË DHE ZHVILLIMIT

Drejtorati për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim (DFEZh) gjatë kësaj periudhe raportuese ka trajtuar 1,728 lëndë të ndryshme. Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2008 janë kryer këto punë:

- (i) Janë shtypur 54,340 fatura të tatimit mbi pronën për vitin 2008 që është më shumë për 1,794 fatura krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2007
- (ii) Janë përgatitur formularët e 1,794 objekteve të regjistruara në teren që është për 755 formular më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit 2007,
- (iii) Janë shpërndarë 4,500 vërejtje të fundit për pagesën e tatimit në pronë,
- (iv) Është siguruar raporti për pagesat e tatimit mbi pronën nga bankat komerciale dhe janë regjistruar në kompjuterë 5,685 pagesa të tatimit mbi pronën të bëra nga tatimpaguesit që është një rritje prej 747 tatimpagues në krahasim me vitin 2007,
- (v) Është bërë përmirësimi në kompjuter i zonave dhe i kategorive tatimore në 310 raste, që është më pak për 110 raste krahasuar me vitin 2007,
- (vi) Është bërë përmirësimi në kompjuter i adresave (rrugëve) për 210 raste që është më pak për 40 raste krahasuar me vitin 2007,
- (vii) Është bërë përmirësimi i gabimeve eventuale teknike në faturat e tatimit mbi pronën për 125 raste që është për 30 raste më pak në krahasim me vitin e kaluar,
- (viii) Janë pranuar 4,069 kërkesa për vërtetimin e tatimit në pronë prej të cilave janë miratuar 4,062 që shënon një rritje prej 669 kërkesave krahasuar me vitin paraprak,
- (ix) Janë pranuar 816 ankesa nga tatimpaguesit, prej të cilave janë aprovuar 599, janë refuzuar 197 kurse 20 ankesa janë në procedurë,
- (x) Janë lëshuar 796 aktvendime në lidhje me ankesat e tatimit në pronë, janë dorëzuar në operativë për ndryshimin e gjendjes 599 vendime kurse në arkiv janë dorëzuar 796 aktvendime për shpërndarje obliguesve.
- (xi) Shërbimi i transaksionit të pronës ka pranuar 1,969 lëndë dhe të gjitha i ka trajtuar në afatin e duhur, që paraqet një rritje prej 151 lëndë krahasuar me vitin 2007.

5.1. Të hyrat vetanake për periudhën janar-qershor 2008

Të hyrat për periudhën janar-qershor 2008 (si dhe për 2007) janë paraqitur në tabelën në vijim. Të hyrat për gjashtëmujorin e vitit 2008 kanë qenë për 24% më të larta se në periudhën e njëjtë të vitit 2007. Realizimi i të hyrave krahasuar me planifikimi për periudhën janar-qershor 2008 ka qenë 43.22%. Pjesa më e madhe e të hyrave për këtë gjashtëmujor është siguruar nga të hyrat nga lëshimi i lejeve ndërtimore (2,449,278 €) dhe nga tatimi në pronë (1,594,455 €).

Nr	Përshkrimi	Janar-Qershor	Janar-Qershor	Rritja e realizimit në 2008 krahasuar me 2007
		2007 (realizimi)	2008 (realizimi)	
		Realizimi		
1		2	3	4=3/2
1	Të hyra tjera	28,370	29,112	3%
2	Administrata	79,082	75,341	-5%
3	Të hyra nga kadastri	207,720	244,699	18%
4	Të hyra nga inspekcioni	45,374	31,702	-30%
5	Shfrytëzimi i sip. publike	217,826	243,635	12%
6	Transakcioni i pronës	344,349	378,479	10%
7	Licenca në biznes	224,532	240,625	7%
8	Të hyra trafik	449,668	447,598	0%
9	Leje ndërtimi	1,732,307	2,449,278	41%
10	Tatimi në pronë	1,292,951	1,594,455	23%
11	Participime / Donacione	44,576	14,000	-69%
12	Arsim	414,812	445,214	7%
13	Shëndetësi	167,508	103,575	-38%
14	Taksa rrugore	-	204,598	-
T O T A L		5,249,072	6,502,310	24%

5.2. Realizimi i buxhetit për periudhën janar-qershor 2008

Në tabelën në vijim është paraqitur buxheti për vitin 2008 dhe realizimi i tij gjatë periudhës raportuese. Në total, për periudhën janar-qershor 2008 buxheti është realizuar në masën prej 19%. Për mallra dhe shërbime është realizuar 37% ndërsa për shpenzime kapitale 15%. Kjo është një dukuri normale pasi pjesa e parë e vitit ka kaluar kryesisht në përgatitje të projekteve dhe në procedura të tenderimit.

Buxheti total për vitin 2008 dhe realizimi për periudhën janar-qershor 2008

Pozicionet buxhetore	Grant	Burimet vetanake	Totali i buxhetit për 2008	Realizimi i buxhetit	
				Janar-qershor 2008	% e realizimit
1	2	3	4=2+3	5	6=5/4
1 Pagat dhe medijtjet	1,442,640	-	1,442,640	488,665	34
2 Mallra dhe shërbime	1,459,530	200,000	1,659,530	614,563	37
3 Shpenzimet komunale	599,000	50,000	649,000	268,588	41
4 Shpenzime kapitale	1,422,062	11,925,000	13,347,062	1,941,102	15
Projektet kapitale sipas drejtorive	1,322,062	9,615,000	10,937,062	1,729,018	16
Administrata e përgjithshme	-	160,000	160,000	-	-
Drejtorati për shërbime publike	150,000	4,720,000	4,870,000	1,085,755	22
Inspekcioni	-	150,000	150,000	77,411	52
Kultura	-	900,000	900,000	105,945	12
Rini dhe sport	-	470,000	470,000	8,054	2
Ekonomia	-	55,000	55,000	-	-
Urbanizëm dhe planifikimi	100,000	1,680,000	1,780,000	12,620	1
Financa dhe pronë	1,072,062	-	1,072,062	258,873	24
Zhvillimi rural	-	1,480,000	1,480,000	180,361	12
Arsimi	50,000	1,610,000	1,660,000	212,084	13

	Shëndetësi dhe mirëqenie sociale	50,000	700,000	750,000	-	-
5	Mbrojtja civile emergjente dhe zjarrfiksat	573,754	985,000	1,558,754	270,318	17
6	Zyra lokale e komuniteteve	295,756	300,000	595,756	60,823	10
7	Zyra për kthim të komuniteteve	6,185	-	6,185	2,053	33
8	Subvencione dhe transfere	-	540,000	540,000	199,387	37
G j i t h s e j		5,798,927	14,000,000	19,798,927	3,845,498	19

5.3. Sektori i zhvillimit

Realizimi i të hyrave nga biznesi për këtë periudhë kohore ka vlerën prej 240,625 € Është realizuar projekti i pestë me radhë investiv për komunitetin e biznesit, ku në bashkëpunim me KFOR-in finlandez janë investuar 75,000 € si mbështetje për bizneset e vogla me makina, vegla pune dhe pajisje tjera. Nga ky projekt kanë përfituar të gjitha minoritetet. Ka filluar të realizohet projekti 'Trajnimi i të rinjve të pa punë në ndërmarrësi' dhe përfundimi i tij pritet në shtator.

5.4. Sektori i bujqësisë

Në periudhën kohore Janar-Qershor 2008 janë përcjell zhvillimet në lëmin e bujqësisë si mbjelljet pranverore, organizimin e korrje-shirjeve, vlerësimin e gjendjes dhe dëmet e shkaktuara në bujqësi, në pyje dhe në Parkun Regjional Gërmia. Më konkretisht:

- (i) janë përcjellur mbjelljet pranverore ku për vitin 2008 në Komunën e Prishtinës janë mbjellë gjithsej 2,751 ha me kultura pranverore,
- (ii) Janë eliminuar qenët endacak përmes N.P.K. Hortikultura,
- (iii) Në lëmin e blegtorisë është përcjellë realizimi i Projektit 'Mbarështimi i dhive në regjionin e Gollakut' në bashkëpunim me shoqatën Heifer International Kosova,
- (iv) Është proceduar projekti në lëmin e bletarisë në bashkëpunim me shoqatën Heifer International Kosova ku përfitues do të jenë 20 familje me nga 4 hoje bletësh nga zonat Dabishevc dhe Hajkobillë (komuna do të të participoj me 4,000 €),
- (v) Janë përgatitur këto projekte për Konferencën e Donatorëve: përkrahja e fermerëve në perimtarri-serra, ngritja e pemishteve, meliorimi i livadheve dhe kullsave, përkrahja e fermerëve në lëmin e blegtorisë, qendra për grumbullimin e fryteve pyjore dhe pasurimi i liqenit të Badovcit me peshk autokton,
- (vi) Janë bërë përgatitjet për fillimin e procesit të korrje-shirjes ku është konstatuar gjendja teknike dhe numri i kombajnave që do të marrin pjesë në procesin e korrje-shirjes si edhe e gjendjes së kulturës së grurit,
- (vii) Në bashkëpunim me Agjensionin Pyjor të Kosovës (APK) është bërë shqyrtimi i kërkesave të bëra nga ana e qytetarëve për prerje në pyjet private,
- (viii) Është bërë vlerësimi i dëmeve në Parkun Regjional Gërmia që është dy metra e gjysmë kub masë drunore.
- (ix) Është përgatitur tenderi për subvencionimin e farës dhe plehrave.

5.5. Inspekcioni i tregut dhe i bujqësisë

Sektori i inspektimit të tregut në kuadër të kësaj drejtorie gjatë periudhës janar-qershor 2008 ka kryer gjithsej 2,489 kontrollime. Të hyrat e arkëtuara nga inspekcioni i tregut gjatë kësaj periudhe kanë qenë 30,377 € të pa inkasuara 269€ ndërsa vlera e mallit të hedhur jashtë qarkullimit ka qenë 16,168.88 € Sektori i inspektimit të bujqësisë ka kryer 826 kontrollime gjatë kësaj periudhe raportuese, Vlera e mallit të asgjësuar gjatë kësaj periudhe ka qenë 26,372 €

6. DREJTORIA E SHËRBIMET PUBLIKE DHE EMERGJENCËS CIVILE

Gjatë periudhës janar-qershor 2008, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës Civile (DSHPEC) ka kryen këto detyra:

- (i) mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve, rregulloreve dhe akteve tjera nënligjore me të cilat rregullohet lëmi e shërbimeve publike, emergjenca civile dhe inspektimi,
- (ii) dhënia e lejeve për shfrytëzimin e hapësirave publike për vendosjen e objekteve të përkohshme,
- (iii) mbikëqyrja e pastrimit të qytetit dhe bartjes së mbeturinave,
- (iv) rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave,
- (v) zgjerimi dhe mirëmbajtjes së hapësirave të gjelbëruara,
- (vi) funksionimi i transportit publik urban të udhëtarëve dhe parkingjeve publike me pagesë.
- (vii) Mbështetur në Statutit e Komunës, DSHPEC ka hartuar Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në Drejtori.

6.1. Sektori i shërbimeve publike

Ky sektor është marrë me mirëmbajtjen e rrugëve, trotuareve dhe varrezave në qytet. Faturat e lëshuara për pagesë nga DSHPEC kompanive për mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve të qytetit të Prishtinës për periudhën janar-qershor 2008 janë si më poshtë:

- (i) Kompania SH.P.K. “Toifor” lotos I (38 rrugë) dhe lotos II (30 rrugë) në vlerë 57.600,00 €
- (ii) Kompania NR “Pastrimi” lotos III (53 rrugë) me vlerë 31.300,00 €
- (iii) Kompania N.N.P. “Noti” që ka të bëjë me grumbullimin dhe bartjen e dheut dhe mbeturinave ndërtimore nga qyteti në deponi në vlerë prej 7.500,00 €

Po ashtu janë zgjedhur kompaninë për mirëmbajtje verore të rrugëve dhe trotuareve të qytetit të Prishtinës gjatë vitit 2008:

- (i) Kompania NR “Pastrimi” të loto I, II, III në shumën prej 59,640.42 €
- (ii) V.Z. “Company” të loto I në shumën prej 18,244,19 €
- (iii) SHPK “Toifor” të loto II në shumën prej 9,503.00 €
- (iv) NR “Pastrimi” të loto III në shumën prej 11,800.00 € (në përpunim).

Për grumbullimin dhe bartjen e dheut dhe mbeturinave ndërtimore nga qyteti në deponinë e licencuar në Mirash është zgjedhur kompania SH.P.K. “Toifor”. Shërbimi po ashtu bënë edhe mbikëqyrjen e punëve nga NK “Hortikultura” për mirëmbajtjen e varrezave të qytetit. Është përgatitur projekti për pastrimin e rrjetit të kanalizimit atmosferik, furnizimi dhe montimi i grilave në rrugët me prioritet të qytetit dhe është dorëzuar në prokurim. Për këtë 6 muaj janë shqyrtuar 33 lëndë, prej tyre janë zgjidhur 27 kurse 6 janë në procedurë për tu zgjidhur.

6.2. Shërbimi elektro-energjetik

Gjatë kësaj periudhe ky shërbim ka zgjidhur 79 kërkesat e arritura. Mirëmbajtja e ndriçimit publik për këtë vit e bënë NP “Termomontimi” në vlerë prej 93.000,00 € Për mirëmbajtjen e Semaforëve për vitin 2008 janë të siguruara mjetet nga Bugjeti i Komunës së Prishtinës në shumë prej 58.959,00 €. Për shpenzimin e energjisë elektrike të ndriçimit publik dhe të semaforëve nga bugjeti i Komunës së Prishtinës janë ndarë mjetet në shumën prej 300,000.00 € Në këtë periudhë kohore

është punuar në mbikëqyrjen e ndriçimin publik të ri dhe kanalizimin kablovik të rrugëve të reja, me sa vijon:

- Ndërtimi/dislokimi i rrjetit elektrik 0,4 kV me ndriçimi publik prej shtyllave të drunjta në shtylla të betonit në rrugën “Vëllezërit Fazliu ” me vlerë të kontratës prej 93,045.85 € (punët kanë përfunduar),
- Dislokimi i rrjetit 0,4 kV i rrugës “Mbretëresha Teutë” faza e dytë me vlerë të kontraktuar prej 20,449.62 € (punët elektrike kanë përfunduar),
- Kanalizimi kablovik energjetik dhe ndriçimi publik në shtylla të hekurta në rrugën e “ Kuksit ” faza e dytë me vlerë të kontraktuar prej 28,490.00 € (punët elektrike kanë përfunduar).

Të hyrat e realizuara nga Shërbimi i Elektro-Energjetik gjatë kësaj periudhe nga lejet e dhëna për gërmimin e kanalit për kablovik kanë qenë 50,955.00 € Gjatë periudhës raportuese kanë arritur 273 kërkesa për shfrytëzimin e hapësirave publike. Të hyrat nga shfrytëzimi i rregullt i hapësirave publike kanë qenë 27,483.80 € Të hyrat nga komisioni për tavolina kanë qenë 116,413.30€ ndërsa të hyrat nga kompania AMM kanë qenë 133,497.60 € Të gjitha këto të hyra kapin një vlerë prej 277,394.70 €

6.3. Shërbimi i transportit

Spektori i Transportit gjatë kësaj periudhe ka përcjell në vazhdimësi mbarëvajtjen e transportit publik në territorin e Komunës së Prishtinës. Kanë vazhduar procedurat për programin e Bankës Botërore për hartimin e planit të veprimit dhe investimeve për qytetin e Prishtinës në mënyrë që të bëhet përmirësimi i transportit, parkingjeve publike, semaforëve etj. Po ashtu, është bërë menaxhimi i shërbimit të merimangë dhe parkingut në Zonën industriale ku vendosen automjetet e konfiskuara nga policia gjatë tërë vitit. Të hyrat e realizuara nga Shërbimi i Transportit gjatë kësaj periudhe kanë qenë 83,086.01 € (nga parkingjet e rezervuara 18,975.00 € nga parkingjet me koncesion 12,800.00 € dhe nga kompanitë merimangë 51,311.01 €).

6.4. Sinjalizimi horizontal dhe vertikal

Për punët në sinjalizimin horizontal dhe vertikal në qytetin e Prishtinës janë ndarë mjete në shumën prej 76,812.25 € Janë hartuar skica të sinjalizimit për disa rrugë dhe lagje të Prishtinës. Është përgatitur materiali tenderues për sinjalizim horizontal dhe vertikal për vitin në vijim.

6.5. Shërbimi i mbrojtjes së ambientit

Në mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbëruara të qytetit kanë qenë të përfshira 453,587.00 m², të cilat kanë qenë të ndara në 5 zona të qytetit: (i) Zona I (Varrezat e Dëshmorëve dhe të Jahudive 73.000 m²), (ii) Zona II (Lagja Ulpiana 110.000 m²), (iii) Zona III (Qendra 50.087 m²), (iv) Zona IV (Lagja Dardania 96.500 m²), (v) Zona V (Kodra e Diellit 124.000 m²). Janë përcjellë në Departamentin e Prokurimit këto projekte: ‘Mirëmbajtja e sipërfaqeve gjelbëruese të qytetit’, ‘Rregullimi i sipërfaqeve gjelbëruese në sheshin Nënë Tereza dhe Zahir Pajaziti’, ‘Rruga Dëshmorët e Kombit’, ‘Vendosja e shportave të mbeturinave në rrugët e Prishtinës’ dhe ‘Renovimi dhe mirëmbajtja e krojeve ekzistuese të Prishtinës’. Për Konferencën e donatorëve për Kosovën kemi përgatitur 2 projekte: ‘Revitalizimi i deponisë së Qytetit në Kodrën e Trimave’ dhe ‘Pyllëzimi i sipërfaqeve të Liqeni i Badovcit’.

Për periudhën gjashtë mujore është bërë rregullimi i sipërfaqeve gjelbëruese te Kompleksi “Qafa” si dhe te “Unioni”. Po ashtu, janë shqyrtuar 50 kërkesa: 16 pëlqime, 2 refuzime, 20 njoftime, 5 intervenime, 4 oferta dhe 3 situacione. Krahasuar me periudhën gjashtë mujore të 2007, në vitin 2008 më tepër ka pas aktivitete në rregullimin e sipërfaqeve gjelbëruese të qytetit.

Të hyrat nga kalimi i laurës për parkun e Gërmisë gjatë periudhës janar-qershor 2008 kanë qenë 54,689.00 € ndërsa të hyrat total nga sektori i shërbimeve publike kanë qenë 466,124.71 € Krahasuar me të hyrat e përgjithshme për vitin 2007 në shumën prej 354,807.84 € vetëm në gjashtëmujorin e parë të vitit 2008 janë mbledhur 32% më shumë të hyra se gjatë gjithë vitit 2007.

6.6. Sektori i emergjencës civile

Gjatë kësaj periudhe janë hartuar dy plane dhe një rregullore: plani Aviano Influenca i dedikuar luftës kundër sëmundjes së shpezëve, plani i reagimit emergjent për ndërtesën e Komunës dhe rregullorja për themelimin e Komitetit për mbrojtje dhe shpëtim. Është bashkëpunuar me DME rreth hartimit të Urdhëresave administrative që dalin nga Ligji për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe Ligji për mbrojtje nga zjarri si dhe përfaqësuesi nga ky sektor ka marrë pjesë në hartimin e planit kombëtar për mbrojtje nga zjarri. Inspektorët e mbrojtjes dhe shpëtimit kanë realizuar këto detyra dhe obligime programore dhe të jashtëzakonshme:

- Hartimi dhe zbatimi i Programit të vizitave inspektuese nëpër të gjitha pompat e benzinës në territorin e komunës (janë vizituar dhe inspektuar 43 pompa të benzinës,
- Analizimi i problemeve që kanë objektet e banimit veçmas ato mbi katër kate,
- Vlerësimi i dëmeve të shkaktuara nga vërshimet (në kategorinë 23 shtëpi, në të dytën 20 shtëpi dhe në të tretën 18 shtëpi),
- Kontrollimi i 34 subjekteve të ndryshme,
- Hartimi i 35 raporte të jashtëzakonshme mbi shpërthimin e zjarreve,
- Përgatitja e propozimit për dislokimin 13 bombolave të gazit si dhe dhënien e pëlqimit për ndërtim të 23 objekteve që i plotësojnë kriteret në bazë të ligjit në mbrojtje nga zjarri.

Brigada për raste teknike ka intervenua 124 herë, kurse për shuarje të zjarrit 397 herë. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ka pasur 81 intervenime teknike më shumë, kurse për shuarje të zjarrit intervenimet përafërsisht janë të njëjta. Në lëmin e aftësimin dhe evidentimit janë vizituar të gjitha strehimoret publike dhe banesore ku janë evidentuar një mori dobësish dhe është konstatuar se ato as nuk i plotësojnë kushtet e nevojshme. Janë vizituar të gjitha shtabet dhe ekipet e MC.

Gjatë kësaj periudhe, Qendra për Informim dhe Alarmim Emergjent ka pasur 916 intervenime ose 274 intervenime më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Qendra gjatë kësaj periudhe i ka pajisur të gjithë shërbyesit civil me ID kartela dhe rregullisht përcjell hyrje-daljet në brendi dhe jashtë objektit. Është vendos Laura/rampa në hyrjen kryesore në ndërtesën e komunës. Rregullisht ka bërë kontrollimin e radio lidhjeve nëpër bashkësitë lokale, programimin e tyre, verifikimin dhe dëgjueshmërinë. Veçmas kontributi i Qendrës ka qenë në dhënien e informatave dhe koordinimin e aksioneve në parandalimin e dëmeve gjatë vërshimeve me 1 dhe 2 qershor. Janë përcaktuar pikat orientuese në qytet rreth alarmimit publik dhe është realizuar projekti për sinjalizimin e alarmimit publik.

Nëse krahasojmë shpenzimet për mallra dhe shpenzimet kapitale të gjysmës së parë të vitit 2007 me gjysmën e parë të këtij viti, atëherë del se sivjet është rritur efikasiteti në pajisjen e BZP-së me

mjete të domosdoshme për reagim në raste emergjente për 22.7% më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit të 2007.

6.7. Sektori i Inspektionit Komunal dhe Komunikacionit

Ky sektor ka mbledhur të hyra për 35% më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Gjatë kësaj periudhe sektori ka ndërmarr këto veprime: kontrollime 11,533, procesverbale 2,257, aktvendime 632, fletëparaqitje për Gjykatë Komunale 254, kërkesa të palëve 354, njoftime për palë 345, aksione me policinë 114, fletëthirrje për palët 124, evidentim të panove – reklamave 721, largim të panove/reklamave 244, largim të shtyllave metalike dhe anti parking nga sipërfaqja publike 486, largim të vazove të luleve dhe zhandonjerëve 42, largim të shtojcave nga lokalet 5, largim të tavolinave shërbyese nga sipërfaqja publike 63, largim të kabëzave nga sipërfaqja publike 5 metra, largim të rrethojave të Pallati i Rinisë 337.5 metra, evidentim të shfrytëzimit të hapësirës publike para lokalit 225, shqiptim i gjobave dhe konfiskim të automjeteve në trafik 75 etj.

7. DREJTORIA E URBANIZMIT, KADASTRËS DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtje të Mjedisit (DUKMM) kryen detyrat e saj të përcaktuara me Statut dhe Rregullore përmes sektorit të urbanizimit, të kadastrit dhe të mbrojtjes së mjedisit. DUKMM gjatë periudhës raportuese ka punuar në realizimin e këtyre objektivave:

- realizimi i infrastrukturës në Planet Rregulluese në koordinim me ndërmarrjet publike përmes grupeve punuese të përbashkëta,
- Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal,
- Hartimi i Planit zhvillimor Urban – revidimi dhe plotësimi i PSZHU,
- Hartimi i planeve të reja rregulluese sipas detyrave programore për hartimin e planeve rregulluese,
- Vazhdimi i hartimit të profilit urban ‘Prishtina e Re’ dhe planeve e projekteve që dalin nga plani strukturor,
- realizimi me koncesion i projekteve kapitale me përmbajtje të llojllojshme në hapësirat e planifikuara.
- përpilimi i një doracaku (udhëzuesi) për opinion me informata për të gjitha rrjedhat në fushën e planifikimi dhe ndërtimit, gjithashtu edhe përmes faqes së internetit.

7.1. Sektori i urbanizmit

Gjatë periudhës raportuese DUKMM ka qenë e përqendruar kryesisht në: (i) përgatitjen dhe hartimin e planeve të reja rregulluese, (ii) realizimin e planeve të miratuara, (iii) caktimin e lokacioneve për komplekse dhe objekte të natyrave të ndryshme dhe (iv) përpilimin dhe lëshimin e lejeve urbane sipas kërkesave. Në bazë të detyrave programore për hartimin të Planeve Rregulluese sipas Vendimit të Kuvendit Komunal të Prishtinës nr. 01-35-2427 dt. 10.09.2004, prioritet i është dhënë hartimit të këtyre projekteve si dhe planeve rregulluese me një sipërfaqe totale prej 1,905 ha:

- Kodra e Trimave I me sipërfaqe prej 550ha,
- Kodra e Trimave II me sipërfaqe prej 575ha,
- Qyteza Pejton me sipërfaqe prej 20ha,
- Vellusha me sipërfaqe prej 22ha,
- Qendra me sipërfaqe prej 20ha,
- Medrese Çamëria me sipërfaqe prej 98ha,
- Zona Ekonomike me sipërfaqe prej 620ha.

Janë caktuar këto lokacione për ndërtime të reja:

- Lokacioni për SH.M. të Teknologjisë Informative,
- Lokacioni për Sh.F. në lagjen Kalabri,
- Lokacioni për SH.M. 'Xhevdet Doda',
- Lokacioni për SH.F. në lagjen Sofali,
- Lokacioni për Stacionin e Metrologjisë,
- Lokacioni për terrene sportive në lagjen "Kodra e Diellit".

Gjatë kësaj periudhe raportuese ka filluar hartimi i profilit urban të lagjes "Prishtina e Re" me sipërfaqe prej ~1,060 ha. Nga viti paraprak është bartur Plani Rregullues i 'Dardanisë' ku ka përfunduar dhe procedura e diskutimit publik. DUKMM ka përpiluar detyrat projektuese për lagjen "Muhaxherët" në bazë të cilave është shpallur tenderi. Ka filluar realizimi i Planeve Rrregulluese të miratuara vitin e kaluar duke miratuar zgjidhjet urbane të blloqeve brenda këtyre planeve sipas kërkesave të investitorëve/pronarëve të tokave në këto lagje: "Dardani", "Mati 1", "Kalabria", "Arbëria 3", "Tophane", "Lakrishte" dhe "Sofali". Në të gjitha këto lagje ka pasur gjithsej 159 kërkesa prej të cilave: informime 88, refuzime 9, kushte urbanistike 46, leje paraprake 4, leje ndërtimi 25 dhe në procedurë 9.

Gjatë periudhës kohore deri te pranimi i zgjedhjes urbane janë organizuar takime/debate me qytetarë gjegjësisht me pronarët e ngastrave katastrale të blloqeve përkatëse urbane. Sektori i Urbanizmi ka qenë i kyçur në projektet e infrastrukturës rrugore dhe ka bashkëpunuar si me nivelin komunal edhe atë qendror. Me qëllim të realizimit të planeve rregulluese, në rastet ku bëhet fjalë për pronën komunale, DUKMM i ka propozuar Kuvendit Komunal, i cili e ka miratuar vendimin për dhënien e tokës për ndërtim me koncesion. DUKMM është duke punuar në përpilimin e detyrave për realizimin e komplekseve kapitale përmes koncesionit, për lokacionet në vijim: objekti i garazhës publike në sheshin "Adem Jashari", sheshin "Zahir Pajaziti" dhe objektet e banimit individual "Mati 3".

Sa i përket planifikimit/projektimit të projekteve të infrastrukturës, janë vizituar dhe fotografuar rrugët të caktuara si prioritet nga Kuvendi Komunal, janë përgatitur detyrat projektuese dhe është përcjellë realizimi i projekteve për:

- Rrugët e qytetit: rruga unazore "Unaza Qendër" pjesa perëndimore, rruga "B" së bashku me rrugët lidhëse, rruga që lidhë rrugën "Tirana" me rrugën "Ahmet Krasniqi" dhe rruga "Tahir Zajmi".
- Rrugët e fshatrave: rruga Prapashticë - Hajkobilë, rruga Dabishevc – Glllogovicë, rruga Llukar – Siqevë dhe rruga Bardhosh- Milevc.

Është mbikëqyrur realizimi i objekteve: "Qendra e Pionerve" në Gërmi, Sh. F. në lagjen "Vreshta", SH.F. në lagjen "Mati 1", Sh.F. në fshatin Glllogovicë, Sh.F. në fshatin Dabishevc, SH.F. në lagjen Halitaj, fasadimi i objektit të komunës në Arbërim, i aneksit të çerdhes "Gëzimi Ynë" në Ulpianë, i objektit të trashëgimisë kulturore "Hamami i madh", i urës në rrugën "Vëllezërit Fazliu", i rrethojës për ambasadën Amerikane në Arbëri, ndërtimi i rrugëve "Mbreti Bardhyl" dhe "Maliq Pashë Gjinolli" në Prishtinë, rrethoja e QMF në lagjen Bregu i Diellit, mbulimi i terasës në IP "Gëzimi Ynë", mbikëqyrja dhe bashkë-menaxhimi i koncesionit për fshatin ndërkombëtar, objekti për banim social, objektet e zyrës së vendit në Besi, ujësjellësi në lagjen Kolovicë, kanalizimi fekal në fshatin Kolovicë, Leban, Prugovc dhe kanalizimi atmosferik përgjatë rrugës "Isa Kastrati".

Gjatë periudhës raportuese ekspertët e DUKMM kanë marrë pjesë në hapjen dhe vlerësimin e tendereve të organizuar nga zyra e prokuimit të komunës për këto projekte: pjesa e unazës qendrore - pjesa perëndimore, lagja “Prishtina e Re”, rrugët “Murat Xhakli”, “GanimeteTërbeshia”, “Selman Kadria”, te Sheshi i Arbërit”, “Aleksandër Mojsiu”, “Antigona Fazliu”, te “Prroi i Kolovicës” , rruga Prapashticë Hajkobilë, Dabishevc - Gllogovicë, Llukar – Siqevë dhe Bardhosh- Milevc.

Gjatë periudhës raportuese, DUKMM i kanë arritur 946 kërkesa nga persona juridik dhe fizik, i cili numër është më i madh krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2007. Gjatë këtij viti zgjidhja e kërkesave është më efikase. Prej 946 ankesave të reja vetëm 440 janë ende në procedurë, ndërsa të tjerat janë zgjidhur.

7.2. Sektori i gjeodezisë dhe kadastrit

Në Sektorin për Kadastër dhe Gjeodezi janë parashtruar një numër më i madh i kërkesave nga persona juridik dhe fizik të paraqitura në vijim krahasuar me vitin 2007. Gjatë kësaj periudhe raportuese kanë arritur 6,029 kërkesa prej të cilave 5,844 janë zgjidhur (ose 97%) dhe vetëm 185 janë ende në procedurë.

7.3. Sektori i inspektionit të ndërtimit

Spektori i inspektionit të ndërtimit, krahasuar me të njëjtën periudhë raportuese për vitin 2007, gjatë periudhës raportuese Janar- Qershor 2008 ka treguar një rritje dukshëm më të lartë të angazhimit sa i përket evidentimit, rrethimit të objekteve, lëshimit të urdhëresave, aktvendimeve si dhe intervenimit në teren që ka të bëjë me rrënimin e objekteve të ndryshme pa leje ndërtimore të filluara, përfunduara dhe të tejkaluara. Gjatë kësaj periudhe raportuese, në këtë sektorë kanë arritur 810 kërkesa prej të cilave 478 janë zgjidhur dhe tjerat janë në procedurë.

7.4. Sektori i mbrojtjes së mjedisit

Ky sektor ka bërë 317 kontrollime gjatë periudhës Janar-Qershor 2008 në lidhje me mbrojtjen e ambientit (ujit dhe ajrit). Sektor i përballet me mungesë të stafit.

7.5. Çështje tjera

Gjatë periudhës raportuese raportues, DUKMM ka lëshuar 16 vërtetime për shkallën e dëmtimit të objekteve nga efektet e luftës, 2 kopje dokumentacioni ku palët i shfrytëzojnë për rregullimin e ndonjë çështje personale pranë gjykatave, 4 kërkesa janë refuzuar si të pa baza kurse 1 lëndë i është përcjell Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale. Të hyrat buxhetore nga tarifat dhe ngarkesat komunale për rregullimin e tokës ndërtimore për këtë periudhë raportuese kapin shumë prej 755.155,42 euro. Gjatë periudhës raportuese është punuar gjithashtu në: përgatitja e propozim-vendimeve me arsyetimet përkatëse të përmendura në këtë raport pune, dhënjën e udhëzimeve profesionale për zbatimin e rregullativës ligjore me rastin e nxjerrjes së akteve nga përgjegjësia e kësaj drejtorie, revokimi i një leje ndërtimore, për shkak të mos respektimit të projektit kryesor etj.

Gjatë kryerjes së punëve dhe detyrave të punës DUKMM ballafaqohet me vështirës që kanë të bëjnë me numrin e vogël të bashkëpunëtorëve profesional, mungesa e infrastrukturës së plotë ligjore, mungesa e të dhënave të sakta statistikore (si regjistrimi i popullsisë), mungesa e standardeve dhe normativave (planifikimit, ndërtimit dhe mirëmbajtjes), atakimi enorm i hapësirave me ndërtime

ilegale dhe uzurpimimi sipërfaqeve tokësore në pronësi të komunës gjë që kanë vështirësi në planifikimin në ato hapësira hapsirave, kufizimi i të drejtës së administrimit të komunës në tokën në pronësi të saj me Rregulloren mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45 si dhe mosdefinimi i pronësisë shoqërore, publike apo komunale etj.

Të hyrat nga lëshimi i lejeve të ndërtimit për periudhën janar-qershor 2008 kanë qenë 2,449,278 € që është për 41% më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit 2007 (kur janë realizuar vetëm 1,732,307 €). Tabelat me të dhëna shtesë për punët e kryera nga DUKMM janë paraqitur në shtojcën e këtij raporti.

8. DREJTORIA E ARSIMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës (DAK) në periudhën gjashtëmujore të këtij viti ka realizuar detyrat sipas dinamikës së planifikuar. Objektivat kryesore të punës të DAK kanë qenë:

1. Realizimi i projekteve të investimeve kapitale për ndërtimin dhe meremetimin e shkollave, objekteve të kulturës dhe sportit dhe objekteve tjera përcjellëse,
2. Sigurimi dhe plotësimi i kuadrit mësimit bazuar në nevojat dhe kërkesat e drejtorive të institucioneve arsimore dhe mbështetja për aftësimin e kuadrit udhëheqës dhe arsimor përmes trajnimeve të organizuara nga MASHT-i, Drejtoria dhe OJQ-të e ndryshme,
3. Ngritja e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie,
4. Organizimi dhe realizimi i aktiviteteve të ndryshme kulture-sportive nëpër shkolla të të gjitha niveleve,
5. Mirëmbajtja e objekteve shkollore duke krijuar kushte optimale për mirëvajtjen e punës mësimore në shkolla.

Arsimi parauniversitar në Komunën e Prishtinës zhvillohet në 82 institucione publike parashkollore dhe shkollore në të tri nivelet dhe ka gjithsej 53,094 fëmijë dhe nxënës të organizuar në 1,896 paralele. Në nivelin parashkollor janë të përfshirë 1,950 fëmijë, të sistemuar në 9 institucione parashkollore respektivisht në 151 grupmosha. Në arsimin parafillor janë 1,600 nxënës në 40 paralele dhe në arsimin e obliguar publik mësimin e kanë vijuar 33,659 të sistemuar në 43 shkolla fillore amë dhe 23 paralele të ndara fizike me gjithsej 1,354 paralele. Qendra burimore 'PËRPARIMI' funksionon në objektin e shkollës 'Naim Frasheri' ku vijojnë mësimin 97 nxënës me nevoja të veçanta. Në nivelin e mesëm të lartë mësimin e kanë vijuar 13,627 nxënës të sistemuar në 364 paralele dhe 12 objekte shkollore. Fëmijët dhe nxënësit e Komunës së Prishtinës edukohen dhe arsimohen edhe në institucionet private parashkollore dhe shkollore. Kështu, 180 fëmije janë të sistemuar në disa institucione parashkollore private, 1,348 nxënës kanë zhvilluar mësimin 6 shkolla fillore private ndërsa 725 nxënës në 7 shkolla të mesme private. Edukimi dhe arsimimi i nxënësve në Komunën e Prishtinës zhvillohet në gjuhën amtare për të gjitha nacionalitetet (shqipe, serbe, boshnjake turke). Në të gjitha këto institucione punojnë 3,342 mësimdhënës dhe shërbimi tjetër teknik-administrativ dhe udhëheqës.

Në Komunën e Prishtinës hapësira e mësimin për kokë nxënësi është 0.86 m², ndërsa sipas standardeve duhet të jetë 1.80- 2.20 m². Nga pjesëmarrja në numër dhe hapësirë të shkollave në nivel vendi, Komuna e Prishtinës përfaqësohet më 7,25% ndërsa pjesëmarrja e nxënësve nga Komuna e Prishtinës në nivel vendi është 15,73% .

8.1. Ngritja e infrastrukturës shkollore, kulture-sportive dhe furnizimet

Gjatë kësaj periudhe u inaugurua një shkollë e re në fshatin Mat, ndërsa filluan së ndërtuari objektet shkollore në Lagjen e Spitalit, Lagjen e Vreshtave, në fshatrat Dabishec dhe Gllugovicë, në Lagjen Halitaj të Mramorit dhe në fshatin Llukar (MASHT). Pos këtyre objekteve shkollore kanë filluar procedurat (shpallja e tenderëve) për ndërtimin e shkollës fillore në Podaj të Koliqit, aneksi i Shkollës fillore në Vranidoll, shkollës fillore në Bardhosh (MASHT), Kalabri dhe Sofali (në procedurë të rregullimit të pronës), laboratore informatike etj.

Janë shpallë tenderët për ndërtimin e katër sallave të kulturës fizike (ndërsa objekti i pestë është në procedurë projektimi) dhe disa terreneve sportive (tereni sportiv në Kodrën e Diellit dhe në lagjet Arbëria dhe Dardani, në Llukar dhe Barilevë, në sh.f. 'Emin Duraku' dhe sh.f. 'Zenel Hajdini'). Po ashtu është bërë përshkrimi i paramasave për trajtimin e oborreve të shkollave fillore në Mat, Kodër të Trimave, Lagjen e Vreshtave dhe në Lagjen e Spitalit.

Nga fusha e kulturës ka vazhduar realizimi i këtyre projekteve: konsolidimi dhe restaurimi i Hamamit të Madh të Prishtinës, ndërtimi i fazës së parë të Qendrës Kulturore të Fëmijëve në Gërmi, Arkivit të qytetit dhe është caktuar lokacioni për ndërtimin e bibliotekës Hivzi Sylejmani në lagjen 'Dardania' në sipërfaqe prej 30 ari.

Janë shpallë tenderët për renovimin dhe lysterjen e 40 institucioneve të të gjitha niveleve. Janë proceduar tenderët për furnizim me material didaktik, rekuizita sportive, material administrativo-pedagogjik, material ushqimor për institucione parashkollore dhe material sanitar për të gjitha nivelet. Po ashtu të gjitha institucionet janë furnizuar me lëndë djegëse. Janë bërë përgatitjet për shpalljen e tenderëve për furnizimet me materialeve të tjera të nevojshme sipas specifikave si: rekuizita didaktike, furnizime me material riparues, transportin e nxënësve dhe mësimdhënësve.

8.2. Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor

Gjatë kësaj periudhe janë organizuar disa trajnime dhe punëtori për aftësimin e personelit arsimor në harmoni me reformat dhe procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Po ashtu janë realizuar 118 vizita informative, 59 vizita speciale në bazë të kërkesave të palëve të interesuara, 28 vizita të përgjithshme dhe 18 vizita kthyese në të gjitha nivelet.

Sipas rezultateve të përpunuara në nivelin e parë (klasat I-V) të arsimit, kalueshmëria e nxënësve ishte 99.6% me notë mesatare 4.2, ndërsa në nivelin e dytë (klasat VI-IX) kalueshmëria ishte 92% me notë mesatare 3.8. Në nivelin e tretë, respektivisht në shollat me arsimim të përgjithshëm (tri gjimnaze dhe medreseja) kalueshmëria ishte 72.8% më notë mesatare 3.7, ndërsa në shkollat profesionale të këtij niveli kalueshmëria ishte 64.3% më notë mesatare 3.4. Në testin kombëtar të semimaturës, shkalla e arritshmërisë ishte 51.75%, ndërsa në testin kombëtar të maturës të nivelit të tretë të arsimit ishte 68.87%, e cila në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ka tendencë rritje më 1.5%.

8.3. Sektori i Kulturës

Aktivitetet në fushën e kulturës janë realizuar sipas prioriteteve të bazuara në strategjinë e veprimit për këtë vit. Janë mbuluar të gjitha ngjarjet e mëdha kulturore të rangut komunal dhe shtetëror: Dita e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, Dita e Prishtinës, Dita e Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, pritja dhe përcjellja e Kryetarit të Republikës së Shqipërisë Z. Bamir Topi në

Prishtinë, Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve, Dita Ndërkombëtare e Muzikës, Festivali “Re Muzika”, Talentët e rinj të muzikës serioze (niveli shtetëror), botimi i disa veprave letrare etj.

Më mbështetje dhe mbikqyrje të DAK-ës, institucionet kulturore të komunës si Teatri Dodona, Qendra Kulturore e Fëmijëve, Biblioteka Hivzi Sylejmani, Arkivi i Qytetit dhe Instituti i Monumenteve kanë kryer një mori projektesh nga fushëveprimi i tyre për nevojat e komunës dhe institucioneve tjera të Republikës së Kosovës. Teatri Dodona ka realizuar pesë shfaqje teatrale ndërsa Qendra Kulturore e Fëmijëve mbi dhjetë koncerte dhe aktivitete tjera për fëmijë dhe të rritur, ka përfaqësuar Kosovën në Festivalin Ndërkombëtarë në Stamboll, Durrës etj. Biblioteka Hivzi Sylejmani ka ofruar shërbime të mjaftueshme të gjithë lexuesve të interesuar për librin. Instituti i Monumenteve në vazhdimësi ka bërë hulumtime dhe gërmime arkeologjike në Prishtinë dhe rrethinë ndërsa Arkivi i Qytetit ka përmbushur kërkesat e parapara me ligj për ruajtjen e lëndës arkivore. Gjatë kësaj kohe Arkivi ka punuar në përpunimin e lëndës arkivore të komunës dhe të disa shkollave.

DAK ka bashkëpunuar me të gjitha institucionet kulturore shtetërore (MASHT, Teatri Kombëtar, Filharmonia, Muzeu i Kosovës, Galeria e Arteve, Ansambli Shota etj) dhe me shumë ambasada, zyra dhe përfaqësi të shteteve të ndryshme që në Republikën e Kosovës.

8.4. Sektori i Sportit dhe Rinisë

Në bazë të prioriteteve dhe planifikimit janë realizuar aktivitete të shumta sportive dhe rinore me rastin e shënimit të datave të rëndësishme historike, kulturore dhe sportive: gjysmë-maratona Ndërkombëtare Prishtina 2008, Lojrat Olimpikë të Kosovës për persona me aftësi të kufizuara (të dytat me radhë), Dita e Evropës më 9 Maj 2008, Dita e Prishtinës më 11 Qershor etj. Nuk ka munguar bashkëpunimi me OJQ-të e ndryshme me të cilat janë realizuar shumë aktivitete sportive dhe rinore: me OJQ-në ‘Sport Sans Frontieres’ nga Franca, Qendra Rinore e Prishtinës, Rrjeti Rinor i Prishtinës, UNDP, Banke Botërore etj. Një bashkëpunim i frytshëm është shënuar edhe më Departamentin e Rinisë në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve që rezultoi me themelimin e grupit inicues të Këshillit të Veprimit Rinor.

Ka shënuar rritje numri i kërkesave të klubeve të sporteve të ndryshme për t’u regjistruar në Sektorin e Sportit të Komunës së Prishtinës, të cilat janë zgjidhur pozitivisht dhe janë përkrahur materialisht. Gjatë këtyre gjashtë muajve kemi pranuar 55 kërkesa për përkrahje materiale të cilat DAK i ka vlerësuar pozitivisht dhe i ka mbështetur. Në përgjithësi, krahasuar me vitin e kaluar gjatë kësaj kohe janë shënuar rezultate më inkurajuese si në vëllimin e projekteve, efikasitetin e realizimit dhe ngritjen cilësore të aktiviteteve të DAK.

8.5. Shërbimi i punëve të përgjithshme administrative

Gjatë kësaj periudhe kohore, drejtorisë i kanë arritur mbi 480 lëndë për shqyrtim, të cilat janë trajtuar në tërësi. Janë shpallur katër konkurse plotësuese për pranimin e kuadrove në shkolla në të tri nivelet. Është bërë përgatitja e konkursit të rregullt për vendet e lira të punës për vitin e ardhshëm shkollor.

8.6. Aktivitetet e tjera

Janë organizuar Garat e Recitatorëve për nderë të “7 Marsit “, Garat e Diturisë për nderë të ”Ditës së Prishtinës”. Po ashtu janë përkrahur të gjitha institucionet shkollore gjatë manifestimeve interne kulturore.

Janë regjistruar 1,600 fëmijë në institucionet para-fillore të sistemuar në 40 paralele, 3.600 nxënës në klasën e parë,dhe ka përfunduar faza e parë e regjistrimit të nxënësve në klasën e dhjetë(në fazën e parë u regjistruan 2400 nxënës.

9. DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS LOKALE

Me riorganizimin e administratës komunale, është formuar Drejtoria e Infrastrukturës Lokale si drejtori e ndarë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike. Kjo Drejtori është përgjegjëse për ndërtimin dhe rindërtimin e infrastrukturës, si në qytetin e Prishtinës ashtu edhe në zonat të asaj rurale: ndërtimi i rrugëve, kanalizimeve atmosferike dhe atyre të ujërave të zeza, ndriçimit publik etj. Drejtoria e Infrastrukturës Lokale, aktivitetet e veta është duke i zhvilluar në bazë të Planit të Punës për vitin 2008. Është punuar në hartimin e paramasave me paralogarive për ndërtime emergjente (rrugë, kanalizime etj).

Kjo drejtori ka qenë e angazhuar në: dhënien e lejeve për ndërtim dhe zhvillime tjera, implementimi i rregulloreve dhe vendimeve komunale brenda përgjegjësive të kësaj drejtorie, organizimi dhe caktimi i komisioneve për kontrollin teknik të objekteve ndërtimore, dhënia e lejeve për përdorimin e objekteve të përfunduara, organizimi dhe kontrollimi i dokumentacionit investues teknik, përgatitja e propozimeve për rregullore dhe akte tjera nga lëmi i ndërtimit, planifikimit dhe projektimit të infrastrukturës lokale, koordinimi dhe kryerja e punëve procedurale nga lëmi i ndërtimit, përgatitja e akteve normative për funksionimin e drejtorisë etj.

Në periudhën janar-qershor 2008, në këtë drejtori kanë arritur gjithsej 198 kërkesa, të cilat janë zgjidhur. Kërkesat kanë të bëjnë kryesisht me dhënien e lejeve për gropimin e kanaleve për kyçje të objekteve në rrjetin e kanalizimit fekal, ndërrimin e rrjetit të ujësjellësit dhe ngrohjes.

Në tabelën në vijim janë paraqitur 20 projekte të infrastrukturës rrugore të realizuara dhe në realizim e sipër që janë të bartura nga viti 2007. Shuma e tyre e përgjithshme është mbi 3,391,903 Euro.

Projektet e infrastrukturës lokale të bartura nga viti 2007

Nr	Emri i projektit (rrugës)	Punë-kryesi	Vlera e punimeve	
1	Ndërtimi i rrugës Shpati	Labi	42,667.52	E përfunduar
2	Ndërtimi i rrugës Nëna Terezë prej Hotel Grandi deri te rruga Eqrem Qabeji	Viktoria Invest	169,034.80	E përfunduar
3	Rruga Vllezërit Fazliu (Pjesa e parë)	Gashi Ing	426,540.98	
4	Rruga Vllezërit Fazliu (Pjesa e dytë)	Eskavatori	605,826.67	
5	Mbretresha Teutë	Noti	133,240.82	E përfunduar
6	Rrugët te Tregu	Albaniku	154,986.09	E përfunduar
	-Mehmet Kaqurri			
	-Taip Krasniqi			
	-Vasil Andoni			
	-Ylfete Humolli			
	-Henrik Bariq			
	-Zija Prishtina			

-Iljaz Agushi				
-Hamdi Mramori				
7	Tahir Meha, Jan Kukuzeli	Albaniku	81,106.59	E përfunduar
8	Kukësi	Labi	187,213.03	E përfunduar
9	Eduard Lirë, Bajram Curri	Shtrasen Tifbau	183,052.15	E përfunduar
10	Bulevardi i Dëshmorëve	Euro Garten	365,462.25	E përfunduar
11	Mbreti Bardhyl, Maliq Pashë Gjinolli	Euro Garten	171,881.62	E përfunduar
12	Janjevë Sushicë	Bageri	189,580.45	E përfunduar
13	Muharrem Fejza II	Kastrioti	113,947.84	E përfunduar
14	Ramë Govori	Labi	78,167.53	E përfunduar
15	Rruga për Sofali	Shtrasen Tifbau	50,606.00	E përfunduar
16	Isa Kastrati	Noti	199,564.24	
17	Ndërtimi I rrugës Vllezërit Fazliu-Elektrika	Monten	93,045.85	
18	Metush Krasniqi II	Noti	14,721.40	E përfunduar
19	Ndërtimi I Murit Mbrojtës në rrugën Vllezërit Fazliu	Gashi ing	87,773.76	E përfunduar
20	Rruga Ismil Ismajli	Noti	43,483.60	E përfunduar
			3,391,903.19	

Gjithashtu janë lidhur edhe 21 kontrata të reja për projekte të reja gjatë vitit 2008, me vlerë rreth 3.17 milion €. Këto janë paraqitur në tabelën më poshtë.

Projektet e infrastrukturës lokale të filluara në viti 2008

Nr	Emri i projektit	Punëkryesi	Vlera e punimeve	
1	Rasim Kiqina	Albaniku	275,059.99	
2	Rifat Krasniqi, Afrim Krasniqi	ABC	44,851.12	E përfunduar
3	Furnizimi me fraksion 0-60 te rruga Vllëzërit Fazliu	Kastrioti Caralevë	25,680.00	
4	Ndërtimi i rrugës Mentor Ratkoceri	Viadukt Prishtinë	91,800.00	
5	Rindërtimi I rrugëve Rexhep Krasniqi, Tahir Zajmi dhe Agim Qela	Viadukt- Prishtinë	256,037.00	
6	Antigona Fazliu	Noti	84,659.73	
7	Bajram Bahtiri dhe rruga e Llapit	Euro Garten	80,781.92	
8	Sheshi i Arbërit	Noti	183,741.62	
9	Selman Kadria	Noti	87,691.20	E përfunduar
10	Kanalizimi në Mat	ABC	48336.72	E përfunduar
11	Luigj Gurakuqi	Labi	51,934.80	
12	Niket Dardani	ABC	98,000.00	
13	Ibrahim kelmendi	ABC	198,000.00	
14	Shkupit	ABC	191,000.00	
15	Asllan Pireva	DIR CO	766,386.19	
16	Aleksandar Moisiu	Nuk është përcaktuar	100,343.00	Ende nuk është nënshkruar kontrata
17	Ndërtimi I trotuarve stacioni I autobusave	ABC	65,048.58	
18	Malush kosova	Noti	420,152.55	
19	Ujësjellësi-Kolovicë	Gashi-Ing	34,761.00	Në fund të realizimit
20	Prugovc-kanalizimi fekal	Labi	75,565.72	Akoma nuk ka filluar
21	Vranidoll-kanalizimi fekal	Area	37,897.48	Në përfundim
			3,169,391.90	

10. DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Sipas strukturës së re organizative, Drejtorati për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (DShMQ) ka tre sektorë: sektori i shëndetësisë primare, sektori i mirëqenies sociale dhe sektori i inspekcionit sanitar. Sektori i shëndetësisë primare aktivitetin e vet e zhvillon përmes QKMF, e cila veprimtarinë e zhvillon përmes 10 QMF-ve, 14 ambulancave shëndetësore, poliklinikës së stomatologjisë me ambulancat shkollore stomatologjike, dispanseri i sëmundjeve të mushkërive dhe entit të ndihmës së shpejtë (ENSHM) në Prishtinë.

Buxheti në dispozicion për këtë drejtori për vitin 2008 është 4,240,036 Euro, prej të cilave 3,220,036 euro vijnë nga granti qeveritar dhe pjesa tjetër prej 1,020,000 euro sigurohet nga burimet vetanake. Me buxhetin e vitit 2008 është përcaktuar numri prej 884 të punësuarve në DSHMS. Nga shuma e përgjithshme e buxhetit vetëm për paga të punëtorëve është paraparë shuma prej 2,097,619 Euro, derisa pjesa tjetër për mbulimin e shpenzimeve tjera përcjellëse si dhe financimin e projekteve të parapara për vitin 2008.

Me qëllim të realizimit sa më të mirë të planit të paraparë, kemi ndërmarrë veprime në drejtim të: shfrytëzimit racional të resurseve njerëzore që ka DSHMS, ngritjes së cilësisë së shërbimeve mjekësore në kujdesin parësor shëndetësor, përmirësimit të disiplinës në punë, zvogëlimit të shpenzimeve, përmirësimit të furnizimit me barna, etj. Në DSHMS gjatë 6 muajve të parë janë adresuar 312 kërkesa, prej të cilave 54 janë pranuar dhe ende janë të pa zgjedhura, 42 janë refuzuar, 174 janë miratuar dhe 42 të tjerat janë kthyer në formë të njoftimeve. Kujdesi parësor shëndetësor përmes QMF-ve dhe ENSH gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti ka ofruar mbi 747,604 shërbime shëndetësore. Inspekcioni sanitar përmes shërbimit sanitar dhe shërbimit veterinar ka realizuar 3,525 shërbime.

DSHMS gjatë gjysmëvitit të parë ka propozuar, hartuar dhe ofruar projektet kapitale për konferencën e donatorëve (Spitali i qytetit, Shtëpia e pleqve dhe Qendra për trajtimin e sëmurëve të rëndë). Në qershor të këtij viti DSHMS është përballë me nevojat emergjente për kategoritë e njerëzve të vërshuar në Kodrën e trimave dhe fshatin Shkabaj. DSHMS ka organizuar vizita në shtëpitë e dëmtuara, formimin e komisioneve vlerësuese të dëmeve dhe ofrimin e ndihmës për kategoritë e dëmtuara rëndë.

Më poshtë kemi radhitur objektivat të cilat konsiderojmë se janë realizuar me sukses gjatë kësaj periudhe: shfrytëzimit racional i resurseve njerëzore në DSHMS, ngritjes së cilësisë së shërbimeve mjekësore në kujdesin parësor shëndetësor, përmirësimit të furnizimit me barna nga lista esenciale dhe plotësimi i saj nga burimet e DSHMS, aktivizimit të QMF në Kodrën e Trimave, ndarjes rajonale të popullatës nëpër QMF-ve, fillimi i kryerjes së dezinfektimit hapësinor të Prishtinës, kryerjes së procedurave për fillimin e ndërtimit të QMF-ve të reja në lagjen e Muhagjerëve, lagjen e Arbërisë, lagjen e Vreshtave, lagjen e Velanisë dhe fshatin Hajvali, përgatitjeve për fillimin e ndërtimit të objektit për strehim kolektiv social, përgatitjet për sigurimin e autoambulancave të reja për nevojat e ENSH, përmirësimit të gjendjes së përgjithshme higjienike-sanitare në Prishtinë.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, përmes vizitave të bëra të gjitha QMF-ve është ngritur niveli i pastërtisë, përgjegjësisë dhe disiplinës në punë, është ndaluar me vendim pirja e duhanit në të gjitha objektet publike të Komunës së Prishtinës, janë aktivizuar të gjitha laboratorët brenda QMF-ve dhe janë ri-organizuar shërbimi i infermierisë dhe vozitësve në ENSH. Janë pranuar pesë mjekë të rinj

për nevojat e ENSH. Me iniciativën e DSHMS është marr vendimi për stimulimin e punëtorëve në shtimin e ditëve të pushimit vjetor në bazë të gjatësisë së përvojës së punës.

Objektivat e renditura më poshtë kanë mbetur të pa realizuara si rezultat i vonësive të zyrës së prokurimit dhe mos efikasitetit të zyrës ligjore, derisa mos implementimi i sistemit të informimit shëndetësor (SISH) në tërësi ka ngec si rezultat i mos përkrahjes së MSH: (i) renovimit të kulmeve në QMF Kodra e Trimave dhe QMF Kalabri, (ii) përgatitja e rregullores së re për ndarjen e qoshqeve për rastet sociale, (iii) përgatitja e rregullores së re për licencimin e ENSH për transportin e pacientëve me gjendje të rëndë shëndetësore jashtë vendit, dhe (iv) implementimit të Sistemit Informatik të Shëndetësisë (SISH) në mjekësinë familjare. Synimet e DSHMS mbeten realizimi i plotë i të gjitha objektivave të parapara për vitin 2008 si dhe realizimi i projekteve afatmesme dhe afatgjata të parapara nga DSHMS në periudhën kohore 2008-2011.

11. DREJTORIA E PRONËS

Drejtorja e Pronës është themeluar gjatë këtij mandati të qeverisjes komunale dhe është në fazën e konsolidimit dhe zhvillimit. Gjatë periudhës janar-qershor 2008, kjo drejtori ka pranuar 546 kërkesa të ndryshme. Drejtorisë i kanë arritur gjithsejtë 301 oferta për shitjen e tokës urbane, objekteve të banimit, lokaleve, garazheve etj. Prej tyre, janë vendosur gjegjësisht janë lëshuar 291 vërtetime që komuna nuk është e interesuar për blerjen e palujtshmërisë përkatëse të ofruara me oferta përkatëse. Të pa përfunduara kanë mbetur 10 kërkesa pasi që është ndërprerë lëshimi i këtyre vërtetimeve. Rreth uzurpimeve arbitrare të tokës në pronësi shoqërore, drejtorisë i kanë arritur 240 kërkesa të ndryshme. Prej tyre janë kryer 55 ndërsa tjerat janë në procedurë e sipër. Gjatë kësaj periudhe janë shqyrtuar edhe disa kërkesa nga viti 2007 të cilat kanë qenë në procedurë.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, kjo drejtori është koncentruar në kryerjen e këtyre lëndëve pronësore:

- (i) ish hotel 'Unioni',
- (ii) qendra 'Dodona, ku është bërë intervistimi i 25 familjeve,
- (iii) Zona industriale,
- (iv) Lokacionet për shkolla dhe QMF,
- (v) Zgjidhja e problemeve pronësore nga viti i kaluar,
- (vi) Inçizimi i gjendjes në Lagjen e Spitalit dhe në Mat,
- (vii) Inçizimi i ndërtesave të ndërtuara pa leje në pronë të komunës etj.

SHTOJCË ME TË DHËNA

Shtojca I: Të dhënat për aktivitetet e Kryetarit të Komunës për periudhën janar-qershor 2008

Përshkrimi i aktiviteteve të Kryetarit	Numri i përgjithshëm i aktiviteteve	Numri i palëve
I. Qeverisja komunale dhe bashkëpunimi ndërinstitucional		
Takime me zyrar komunal	56	182
Vizita në terren për inspektimin e punimeve infrastrukturore	13	
Drejtimi i grupeve punuese, këshilli i drejtorëve, mbledhje te komitetit për politike dhe financa, mbledhje te ndryshme	55	
Takime konsultative individuale me drejtoret	72	
Bashkëpunimi dhe koordinimi me institucione publike dhe administratë publike, lokale rajonale dhe qendrore	35	77
Takime dhe bashkëpunim me përfaqësues të partive politike	28	83
Takim me Institucionet qendrore (Presidenti, Kryeministri, Ministra, përfaqësues të universitetit publik)	51	
Takime zyrtare jashtë objektit të komunës	20	
Pjesëmarrje në ceremoni zyrtare, festa dhe ditë përkujtimore	84	
II Transparenca, komunikimi dhe përfshirja e qytetarëve në qeverisje		
Konferenca dhe seminare	49	
Takime individuale me Qytetarë	57	179
Takime, prezantime, debate publike	30	
Takime me media	10	67
Takim me drejtues të mediave	7	23
Shoqëria civile (përfaqësues të OJQ-ve)	18	60
Takim me përfaqësues të sindikatës	2	7
Komuniteti Fetar	8	24
III. Siguria Publike		
Takime më përfaqësuese të prezencës ushtarake ndërkombëtare KFOR, TMK, SHPK	34	
IV. Zhvillimi ekonomik		
Takime me investitorët e jashtëm	19	63
Bashkëpunim me institucione financiare ndërkombëtare dhe banka qe operojnë në tregun vendor	3	
Takime me biznesin lokal	23	75
V. Bashkëpunimi ndërkombëtar		
Takime me përfaqësues të Ambasadave	46	123
Udhëtime zyrtare jashtë vendit	7	
Takime me përfaqësues të UNMIK, OSBE, BE, BB, FMN, CPI, Komision Evropian etj.	27	
VI. Shqyrtim i kërkesave të qytetarëve		
Kërkesa të shtruara zyrës së kryetarit	767 te gjitha te orientuara ne organet kompetente	

Shtojca II: Të dhëna nga Drejtoria e Urbanizmit, Katastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Sektori i Urbanizmit: Lëndë Sipas subjektit të lëndës

	LËNDËT	Mr. Lëndëve	Të Zgjidhura si								Të trajtuara	Në trajtim	
			Sipas Kërkesës	Leje Ndertimore	Kush. Urbanistike	Refuzim	Informim	Plot. Dokum.	E përcjellur	Ndryshe			
1	Ankesë	76			1	27	7			15	2	52	24
2	Caktimi i Pikave	10	8									8	2
3	Dëmet e Luftës	20	18									18	2
4	Fillimi i Punimeve	3						1		1	1	3	0
5	Informim	11						9				9	2
6	Intervenim	2						1			1	2	0
7	Kushtet urbanistike	332			72	90	101	7			19	289	43
8	Proj.për Kush.Urb.	1						1				1	0
9	Kërkesë	200				21	71	2	13	31	138	62	
10	Leje ndërtimi	45		23			3	2		11	39	6	
11	Leje paraprake	4	4									4	0
12	Leje Përdorimi	2	1									1	1
13	Legalizim	18				18						18	0
14	Lokcion	19			1		10				1	12	7
15	Njoftim	18	5				1		3			9	9
16	Projekt Ideor	62			9	1	8	3		28	49	13	
17	Projekt Kryesor	2					1					1	1
18	Para Projekt	1									1	1	0
19	Plotësim i kërkesës	10	6		1				2		9	1	
20	Pranim Teknik	9	2				3		1	2	8	1	
21	Konkluzë	11	1		6		1			2	10	1	
22	Parashtesë	1										0	1
23	Projekt Zbatues	1		1								1	0
24	Pëlqim	8				2	3		1	2	8	0	
25	Propozim	1					1					1	0
26	Përgjigje	1										0	1
27	Referim	1										0	1
28	Renovim	5				2	2			1	5	0	
29	Rishqyrtim i Lëndës	1					1					1	0
30	Rrënim Objekti	2				1	1					2	0
31	Shqyrtimi i Projektit	1					1					1	0
32	Termin	7	1				1					2	5
33	Terren	1					1					1	0
34	Urgjencë	4					2					2	2
35	Zgjerim	1				1						1	0
36	Ndarje e Parcelave	1							1			1	0
37	Dërgim i lëndëve në kompetence	6				1	1				1	3	3
38	Shëndrrime	38		1	11	19	3			1	35	3	
39	Informata nga plani	2					2					2	0
40	Të pa emërtuara	8										0	8
Gjithsejt		946	46	25	101	183	237	14	37	104	747	199	

Sektori i Urbanizmit: Sipas lagjeve

	Kërkesa	Informime	Refuzime	Kushte urbanistike	Leje Paraprake	Leje ndërtimi	Ne procedure
Dodona	24	2	2	15	0	4	1
Mati 1	54	35	4	8	2	1	4
Kalabria	28	13	2	11	0	1	1
Arbëria 3	8	5	0	2	0	1	0
Tophane	13	12	1	0	0	0	0
Larishte	13	2	0	6	2	0	3
Sofali	25	16	0	6	0	3	0
	159	86	9	48	4	10	9

Sektori i Katastrit dhe Gjeodezisë: Llojet e shërbimeve të kryera

Nr.	Llojet e Shërbimeve	Janar-Qershor	
		2007	2008
1	Fletë Poseduese	3,815	4,680
2	Kopje Plani	3,742	4,171
3	Ndërrimet dhe bartjet në operat	1,546	1,642
4	Lëndet e terrenit	346	394
5	Certifikata të ndryshme	2,118	6,621
6	Lëndë të intabulikit-hipotekave	567	660
7	Vërtetime	73	68
8	Gjithësejtë	12,134	18,168

Sektori i inspeksionit të ndërtimit: Veprimet e ndërmarra

		Janar-Qershor	
		2007	2008
1	Ndërtime të evidentuara	242	321
2	Thirrje	232	321
3	Procesverbale	234	330
4	Aktvendime për ndërprerje të punëve	123	238
5	Urdhëresa	2	4
6	Aktvendime për rrënim	67	84
7	Objekte të rrethuara	12	52
8	Objekte të rrënuara	36	48
9	Ndërtime në lagje të urbanizuara	141	174
10	Ndërtime në lagje të pa urbanizuara	102	167
11	Ankesa të qytetarëve	120	179
12	Ankesa të shqyrtuara	109	87
13	Gjithsej	1,420	2,005

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. Nr. 031-1328, dt.11.9.2008

KRYETARI I KOMUNËS

Prof dr. Isa Mustafa